

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5403
E enjte, 15 shkurt 2018
çmimi 0.40 €

SBASHK-u 'kërcënon'
sërish me grevë nëse nuk
realizohen kërkesat ■ PAGE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

**THAÇI SËRISH KRITIKON
GJYKATËN SPECIALE F. 3**

**OVLUÇK-JA: TË MOS
NËPËRKËMBEN AS FLAMURI
KOMBËTAR E AS AI
SHTETËTOR F. 7**

**GAP-i: MANDATIN E KALUAR
KRYETARËT E KOMUNAVE
PËRMBUSHËN GJYSMËN E
PREMTIMEVE F. 6**

EKONOMI

**ATK-JA PËR 18 VJET INKASOI
5.2 MILIARDË EURO F. 7**

**ZHANG: KOSOVA DUHET
T'I VAZHDOJË REFORMAT PËR
RRITJE MË TË MADHE
EKONOMIKE F. 9**

KULTURË

**PROMOVHET MONOGRAFIA E
KOLË KRASNIQIT F. 15**



SPORT

**LLAPI DËSHMON FORCËN,
KUALIFIKOHET NË
ÇEREKFINALE F. 16**

**KOSOVA NË MARS ZHVILLON
DY NDESHJE MIQËSORE F. 16**

KRYEMINISTRI I
MALIT TË ZI,
DUSHKO
MARKOVIQ, PO
QËNDRON NË
KOSOVË PËR
NJË VIZITË
DYDITORE

Mali i Zi i gatshëm ta ndihmojë Kosovën për ratifikimin e demarkacionit



Kryeministri malazez Dushko Marković ka bërë me dije se Mali i Zi dëshiron ta ndihmojë Kosovën për zgjidhjen e çështjes së demarkacionit, edhe pse ai ka thënë se kjo marrëveshje është rumbullakuar me ratifikimin e saj në Kuvendin e Malit të Zi. Në një konferencë të përbashkët për medie, mbajtur pas takimit që zhvilloi në ndërtesën e Qeverisë së Kosovës, Haradinaj dhe Marković nuk dhanë detaje se si do të zgjidhet kjo çështje, por bënë me dije se përmes dialogut do të gjendet një zgjidhje e mirë që edhe Kosova ta ratifikojë demarkacionin. Edhe kryeministri Ramush Haradinaj ka shprehur optimizëm se mund të kalohet situata aktuale sa i përket çështjes së demarkacionit ■ PAGE 4-5

Gabriel: Serbia s'mund të integrohet në BE pa e njohur Kosovën

Ballkani Perëndimor e ka vendin në Bashkimin Evropian (BE). Kështu ka deklaruar të mërkurën në Prishtinë ministri i Punëve të Jashtme i Gjermanisë, Sigmar Gabriel, pas takimit me kryeministrin Ramush Haradinaj. Diplomati gjerman ka shprehur zotimin e Gjermanisë për ta

mbështetur Kosovën në rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian. Megjithatë, ai ka thënë se për t'u bërë pjesë e BE-së duhet të plotësohen kriteret e kërkuara. Gabrieli ka treguar se ia kanë bërë të qartë Serbisë se pa e njohur pavarësinë e Kosovës nuk do të mund të jetë pjesë e Bashkimit Evropian ■ PAGE 3



Selia e Qendrës së Arsimit për Diasporën do të jetë në Prishtinë

RENOVA
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Çarëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GRUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Selia e Qendrës së Arsimit për Diasporën do të jetë në Prishtinë

Këshilli i përbashkët për implementimin e marrëveshjes për mësimin shqip në diasporë ka marrë vendim për ngritjen e Qendrës Arsimore në Diasporë, me seli në Prishtinë, e cila do të jetë në funksion të implementimit të detajeve teknike të marrëveshjes që është një hap i rëndësishëm për unifikimin e mësimin shqip në diasporë

EPOKA E RE**Qendresa RAMA**

TIRANË, 14 SHKURT - Të mërkurën në Tiranë është mbajtur takimi ndërministror Kosovë - Shqipëri për mësimin shqip në diasporë. Ky takim mes dy ministrave të Diasporës dhe dy ministrave të Arsimit të Republikës së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë është vazhdimësi e procesit të implementimit të marrëveshjes për mësimin shqip në diasporë.

Në këtë tryezë ishin të pranishëm ministri i Diasporës dhe i Investimeve Strategjike, njëherësh zëvendëskryeministër, Dardan Gashi, ministrja e Arsimit, Sportit dhe e Rinisë e Republikës së Shqipërisë, Lindita Nikolla, ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko, dhe zëvendësmministri i Arsimit, i Shkencës dhe i i Teknologjisë, Hestet Sahiti. Gjatë takimit tre ministrat u informuan për procesin e deritashëm, për fazat e



implementimit të marrëveshjes, si dhe për hapat e mëtejshëm. Të tre ministrat u pajtuan të themelohet këshilli i përbashkët për implementimin e marrëveshjes. Ky i fundit ka marrë vendim për ngritjen e Qendrës Arsimore në Diasporë, me seli në Prishtinë, e cila do të jetë në funksion të implementimit të

detajeve teknike të marrëveshjes. "Ky është një hap i rëndësishëm drejt unifikimit të mësimin shqip në diasporë. Tani kemi zotime të përbashkëta për hapa konkretë në drejtim të implementimit të plotë të marrëveshjes ndërshtetërore, të nënshkruar mes dy kryeministrave", ka thënë zëvendëskryeministri Gashi.

Në anën tjetër, ministrja e Arsimit e Shqipërisë, Lindita Nikolla, i ka përgëzuar të dyja qeveritë për angazhimin që kanë marrë për mbrojtjen e gjuhës, kulturës dhe të identitetit shqiptar. "Unifikimi i sistemit arsimor është një hap shumë i rëndësishëm", ka theksuar Nikolla. Ndërsa ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko, ka thënë se sot, në prag të 10-vjetorit të pavarësisë së Kosovës, kemi çfarë t'i themi publikut. "Brenda një kohe të shkurtër, pas mbledhjes së përbashkët mes dy qeverive, morëm disa vendime të rëndësishme, si ai lidhur me krijimin e Qendrës për Arsimin në Diasporë", ka thënë Majko. Ky takim do të vazhdojë në nivelin teknik dhe do të rezultojë me nxjerrjen e konkluzioneve të tjera.

Presidenti Meta konsultohet me ish-presidentët për marrëveshjen me Greqinë

TIRANË, 14 SHKURT - Pas mbërritjes së kërkesës për plotfuqishmëri në bisedime me Greqinë, nga ana e ministrit të Jashtëm, Ditmir Bushati, për presidentin Ilir Meta, kanë nisur menjëherë kontaktet. Burime nga Presidenca kanë konfirmuar se kërkesa nga Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme ka mbërritur të martën në mbrëmje.



Meta janë një praktikë e re për funksionimin e këtij institucioni, duke synuar që vendimet të jenë sa më konform Kushtetutës, ligjeve dhe këndvështrimeve të politikanëve me përvojën në drejtimin e shtetit.

Pritet që presidenti Meta të konsultohet edhe me ish-presidentët e tjerë gjatë këtyre dy ditëve e më pas të kthejë një përgjigje për ministrin e Punëve të Jashtme, Ditmir Bushati.

Ky i fundit ka zhvilluar dy takime negociatash me homologun e tij grek, Nikos Kotzias. Në takimin e zhvilluar në Korçë është arritur marrëveshja për faljen e detit nga Shqipëria, Greqisë.

Po të mërkurën, sipas burimeve pranë Presidencës, mësohet se në institucionin e Presidencës ka mbërritur ish-presidenti Bamir Topi. Menjëherë pas letrës së ministrit Bushati, presidenti Meta ka vijuar konsultimet me presidentët e mëparshëm.

Konsultat me ish-krejtë e shteteve nga ana e presidentit Ilir

Stoltenbergu vlerëson kontributin e Shqipërisë në misionet paqeruajtëse

BRUKSEL, 14 SHKURT - Ministrja e Mbrojtjes të Shqipërisë, Olta Xhaçka, zhvilloi një takim të veçantë me sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, gjatë takimit të ministrave të mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s, që mbahet më 14 dhe 15 shkurt në Bruksel. "E informova sekretarin e përgjithshëm mbi angazhimin e Shqipërisë, që brenda vitit 2024, dy për qind e Prodhimit të Brendshëm Bruto t'i dedikohet fushës së mbrojtjes, si edhe rikonfirmova rritjen e angazhimit të vendit tonë në të gjitha misionet e NATO-s dhe BE-së, apo edhe në misionin e ri kombëtar siç janë emergjencat civile", tha ministrja Xhaçka pas takimit.



Nga ana e tij, Stoltenbergu

vlerësoi angazhimin e Shqipërisë për t'i përmbyshur detyrimet e ndërmarrë në kuadër të buxhetit, dedikuar në fushën e mbrojtjes.

NATO-s njëherësh vlerësoi kontributin njerëzor të Shqipërisë në misionet paqeruajtëse për përkushtimin dhe profesionalizimin e ushtarakëve shqiptarë.

Bushati: Holanda vlerëson progresin e Shqipërisë

TIRANË, 14 SHKURT - Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, Ditmir Bushati, zhvilloi një takim me ministrin holandez për Drejtësinë dhe Çështjet e Sigurisë, Ferdinand Grapperhaus. Ministrat diskutuan për bashkëpunimin mes dy vendeve, perspektivën evropiane të Shqipërisë, bashkëpunimin në përballjen me sfidat e sigurisë dhe me shtetin e së drejtës, si dhe luftën

kundër krimit të organizuar. Ministri Bushati e njohu zrytarin e lartë holandez me hapat konkretë të ndërmarrë nga Qeveria shqiptare në fushën e reformave dhe në përmbyshje të prioritetëve kryesorë për hapjen e negociatave për anëtarësim. Ministri Bushati u ndal veçanërisht te reforma në drejtësi, e cila, sipas tij, ka nisur t'i japë rezultatet e para dhe

është pararojë edhe për vendet e rajonit.

Ministri Grapperhaus u shpreh se Holanda është e hapur për të bashkëpunuar me Shqipërinë dhe se vlerëson punën e bërë kohët e fundit, kryesisht në fushën e sundimit të ligjit dhe shtetit të së drejtës.

Ministrat diskutuan edhe për situatën në rajon. Ministri Bushati theksoi se Shqipëria është faktor stabiliteti dhe sigurie.



Ministri i Punëve të Jashtme i Gjermanisë, Sigmar Gabriel, po qëndron për vizitë në Kosovë

Gabrieli: Serbia s'mund të integrohet në BE pa e njohur Kosovën

Ballkani Perëndimor e ka vendin në Bashkimin Evropian (BE). Kështu ka deklaruar të mërkurën në Prishtinë ministri i Punëve të Jashtme i Gjermanisë, Sigmar Gabriel, pas takimit me kryeministrin Ramush Haradinaj. Diplomati gjerman ka shprehur zotimin e Gjermanisë për ta mbështetur Kosovën në rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian. Megjithatë, ai ka thënë se për t'u bërë pjesë e BE-së duhet të plotësohen kriteret e kërkuara. Gabrieli ka treguar se i kanë bërë të qartë Serbisë se pa e njohur pavarësinë e Kosovës nuk do të mund të jetë pjesë e Bashkimit Evropian



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 14 SHKURT - Ministri i Punëve të Jashtme i Gjermanisë, Sigmar Gabriel, të mërkurën ka vizituar shtetin e Kosovës, me ç'rast ka thënë se Qeveria gjermane do ta vazhdojë mbështetjen për Kosovën në të gjitha aspektet. Ai e ka përgëzuar Kosovën për të arriturat në prag të shënimit të 10-vjetorit të pavarësisë. "Në emër të Republikës Federale të Gjermanisë ju përgëzoj për përvjetorin e dhjetë të pavarësisë. Është një mundësi e mirë për t'i përgëzuar qytetarët e vendit për këtë përvjetor jubilar. Gjermania bën pjesë tek vendet më të para që e kanë njohur Kosovën shtet dhe, marrë parasysh sfidat që i ka përjetuar Kosova në këtë proces, duhet të jetë krenare për të arriturat e deritanishme. Ne e dimë se sfidat edhe më tej janë të mëdha dhe Gjermani dëshiron të mbetet edhe në të ardhmen një partnere e qëndrueshme jo vetëm në sferën

politike, por edhe në atë ekonomike. Shpresojmë se Kosova do të arrijë një stabilitet ekonomik dhe politik, sepse qytetarët e meritojnë këtë", ka deklaruar Gabrieli në një konferencë të përbashkët për medie me kryeministrin Ramush Haradinaj. Pavarësisht prej progresit, Gabrieli ka thënë se Kosova para vetes ka sfida të mëdha. Sipas tij, një prej këtyre sfidave është edhe Gjykata Speciale. "Pra, ka sfida të cilat duhet të zgjidhen, siç është zbatimi i ligjit, zbatimi i reformave dhe, po ashtu, është çështja e gjyqësorit të pavarur. Ne dëshirojmë t'u ndihmojmë në zbatimin e shtetit ligjor dhe ta ofrojmë asistencën e shtetit tonë me aq sa mundemi. Përveç kësaj, angazhohemi që Kosova të përgatitet për çështjet jo të këndshme. Një nga ato janë Dhomat e Specializuara, të cilat do t'i trajtojnë krimet e mundshme të luftës", është shprehur ai. Diplomati gjerman ka kërkuar që Kuvendi i Kosovës sa më

shpejt ta ratifikojë marrëveshjen për demarkacion me Malin e Zi në mënyrë që qytetarët e Kosovës ta fitojnë liberalizimin e vizave. "Jam i lumtur sepse kam dëgjuar se ka vullnet për t'u zgjidhur edhe çështja e demarkacionit me Malin e Zi. Ne e mbështesim këtë sepse është në të mirë të qytetarëve të Kosovës, në mënyrë që ky kriter të plotësohet dhe të ketë liberalizim të vizave. Shpresojmë se marrëveshja me Malin e Zi të ratifikohet së shpejti dhe të fitohet shpejt liberalizimi i vizave. Ne e duam lëvizjen e lirë për qytetarët e Kosovës", ka deklaruar Gabriel. Po ashtu, ai ka premtuar se Gjermania do të vazhdojë ta përkrahë Kosovën në rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian. Megjithatë, ai ka thënë se për t'u bërë pjesë e BE-së duhet të plotësohen kriteret e kërkuara. Gabrieli ka treguar se ia kanë bërë të qartë Serbisë se pa e njohur pavarësinë e Kosovës nuk do të mund të jetë pjesë e Bashkimit Evropian. "Do ta

mbështesim Kosovën në rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian, por duhet të plotësohen kushtet e kërkuara. Fillimisht duhet të përmirësohet jeta e qytetarëve, të zbatohen reformat dhe të ketë zhvillim të përgjithshëm. Të mërkurën në Beograd kemi theksuar se nëse Serbia dëshiron të shkojë në drejtim të Bashkimit Evropian atëherë duhet t'i plotësojë kriteret e shtetit ligjor, natyrisht edhe pranimin e pavarësisë së Kosovës, sepse ky është një parakusht për rrugën e saj në BE. Dhe për këtë ju mund të llogaritni në mbështetjen tonë. Do të angazhohemi për t'i bindur edhe pesë vendet e BE-së për ta njohur Kosovën. Çështja e Kosovës dhe Serbisë duhet të zgjidhet njëherë e përgjithmonë sepse këto dy vende nuk mund të jenë pjesë e BE-së pa i zgjidhur problemet mes vete. Ky është parakusht për paqen dhe ju do ta keni mbështetjen tonë në këtë proces. Ballkani Perëndimor e ka vendin në Bashkimin

Evropian", ka theksuar Gabriel. Ndërsa kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka falënderuar ministrin gjerman për mbështetjen që shteti i tij i ka dhënë Kosovës në të gjitha proceset. Ai ka treguar se Gjermania po vazhdon ta mbështesë Kosovën euroatlantike. "Është nder i veçantë që në Kosovë ta kemi ministrin e Punëve të Jashtme të Gjermanisë. Kjo ishte një mundësi ideale për t'ia shpjeguar ministrit zhvillimet në Kosovë si dhe t'ia paraqesim bindjet tona për të arriturat tona në dhjetëvjetorin e pavarësisë. Njëkohësisht, në emër të Qeverisë dhe të qytetarëve, e kam falënderuar ministrin dhe shtetin e Gjermanisë për përkrahjen e Kosovës në të gjitha proceset dhe në të gjitha dimensionet. Po ashtu, Gjermania po e mbështet Kosovën edhe tani në perspektivën tonë euroatlantike", ka deklaruar kryeministri Haradinaj.



Thaçi sërish kritikon Gjykatën Speciale

Prishtinë, 14 shkurt - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, e ka cilësuar Gjykatën Speciale "padrejtësi historike" dhe ka thënë se Qeveria e ka pranuar atë pa dëshirë si "çmim për lirinë e saj". Në një

intervistë për "Associated Press", pak ditë para shënimit të 10-vjetorit të pavarësisë së Kosovës, presidenti ka kritikuar gjykatën me seli në Holandë, duke thënë se e njëjta është e ngjashme me krijimin e ndonjë

gjyqate që do t'i gjykonte hebrenjtë që janë përndjekur nga nazistët në Luftën e Dytë Botërore. "Kosova ka luftuar për ta mbrojtur ekzistencën e kombit dhe nuk ka sulmuar askënd. Nuk kemi asgjë për të

fshehur", ka thënë ai. Ndërkaq ambasadori amerikan në Kosovë, Greg Delawie, ka thënë të mërkurën se Gjykata Speciale e ka synim sigurimin e drejtësisë për viktimat.



Kryeministri i Malit të Zi, Dushko Marković, po qëndron në Kosovë për një vizitë dyditore

Mali i Zi i gatshëm ta ndihmojë Kosovën për ratifikimin e demarkacionit

Kryeministri malazez Dushko Marković ka bërë me dije se Mali i Zi dëshiron ta ndihmojë Kosovën për zgjidhjen e çështjes së demarkacionit, edhe pse ai ka thënë se kjo marrëveshje është rrumbullakuar me ratifikimin e saj në Kuvendin e Malit të Zi. Në një konferencë të përbashkët për medie, mbajtur pas takimit që zhvillohet në ndërtesën e Qeverisë së Kosovës, Haradinaj dhe Marković nuk dhanë detaje se si do të zgjidhet kjo çështje, por bënë me dije se përmes dialogut do të gjendet një zgjidhje e mirë që edhe Kosova ta ratifikojë demarkacionin. Edhe kryeministri Ramush Haradinaj ka shprehur optimizëm se mund të kalohet situata aktuale sa i përket çështjes së demarkacionit

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 14 SHKURT - Kryeministri i Malit të Zi, Dushko Marković, dhe ai i Kosovës, Ramush Haradinaj, të mërkurën kanë shprehur optimizëm për gjendjen e një zgjidhje për çështjen e demarkacionit ndërmjet dy vendeve. Ndonëse nuk kanë treguar se cila është kjo zgjidhje, në një konferencë të përbashkët për medie të dy kryeministrat kanë deklaruar se do të angazhohen për daljen nga kjo situatë.

Kreu i qeverisë malazeze ka thënë se vendi i tij nuk ka probleme me Kosovën dhe se dëshiron ta ndihmojë atë rreth çështjes së demarkacionit. "Kemi folur edhe për demarkacionin. Dy kryeministrat e përgjegjshëm duhet të bisedojnë për këtë çështje, e cila është e rëndësishme për të dy vendet. E dini se kur është fjala për Malin e Zi, çështja e marrëveshjes së demarkacionit është rrumbullakuar me ratifikim në Kuvend, kurse në Kosovë Kuvendi nuk e ka ratifikuar këtë marrëveshje. Mali i Zi, si fqinj i mirë, dëshiron ta ndihmojë Kosovën që kjo çështje të

zgjidhet", ka thënë Marković. Ai ka bërë me dije se për këtë çështje tashmë ekziston një dialog në mes të dy vendeve, i cili do të ndihmojë për gjetjen e një zgjidhje. "Kemi biseduar për këtë çështje me qëllimet më të mira si miq dhe në vazhdimësi të dialogut, i cili tashmë ekziston. Do ta gjejmë zgjidhjen më të mirë që ta kemi marrëveshjen e ratifikuar dhe që Kosova në këtë mënyrë të fitojë një mundësi të mirë kur flitet për integritet evropian", ka thënë kryeministri i Malit të Zi, Dushko Marković. Edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pranuar





përvojën e vet në këto procese ta ndihmojë zhvillimin më të shpejtë të integritimit evropian dhe euroatlantik", ka thënë Markoviqi, duke përmendur edhe avancimin e marrëdhënieve ekonomike ndërmjet dy shteteve. "Gjithashtu, dëshirojmë që me Kosovën ta zhvillojmë edhe bashkëpunimin e mirë ekonomik. Kemi biseduar sot për këtë në takim me kryeministrin Haradinaj dhe bashkëpunëtorët e tij, që marrëdhëniet e mira ndërshtetërore t'i zhvillojmë edhe me një bashkëpunim të mirë ekonomik. Kam propozuar që shumë shpejt të arrijmë një bashkëpunim ndërmjet dy odave ekonomike, pastaj që ministrinë e linjës t'i nënshkruajnë marrëveshjet e duhura dhe të merremi me zhvillimin e infrastrukturës si një fazë kyçe për një zhvillim më të shpejtë ekonomik", ka thënë ai.

Gjithashtu, Markoviqi ka treguar se në këtë takim është biseduar edhe për komunitetin malazez në Kosovë. "Besoj se së shpejti do të kemi edhe një pozitë kushtetuese për komunitetin malazez, megjithatë dua t'ju falënderohem që ju personalisht dhe qeveria e juaj keni bërë strategjinë e cila mundëson një integritim më cilësor të komunitetit malazez në jetën shoqërore të Kosovës", ka thënë Markoviqi.

Ndërsa kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka vlerësuar se në Kosovë ekziston një unitet për pozitën kushtetuese të komunitetit malazez. "Ne vetëm kemi bërë disa veprime të para sa iu përket kërkesave të bashkësisë malazeze që jeton në Kosovë. Janë disa kërkesa të para që janë përmbushur vitin që shkoj, njëkohësisht jemi në zbatim të një plani aksional që buron nga strategjia që e ka aprovuar Qeveria e vendit. Rezultatet do t'i komunikojmë me kohë. Mund t'ju them se në Kosovë ka një unitet që të respektohet pozita dhe kërkesat e bashkësisë malazeze në Kosovë. Ka qenë një gatishmëri e mëhershme për një pozicion kushtetuese të këtyre të drejtave", ka thënë Haradinaj.

Haradinaj e Markoviqi flasin edhe për integritet evropian dhe komunitetin malazez

Përveç çështjes së demarkacionit, kryeministrat e Malit të Zi dhe të Kosovës kanë diskutuar edhe për avancimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve. I pari i Qeverisë malazeze është shprehur i gatshëm ta mbështesë Kosovën në rrugën e integritimit euroatlantik. "Kemi ardhur në një vizitë miqësore të një fqinj i mirë. Dëshirojmë që në të ardhmen ta mbështesim Kosovën në rrugëtimin e saj të integritimeve evropiane dhe euroatlantike. Mali i Zi, si anëtar i NATO-s dhe si shtet që ka avancuar mjaft me negociatat me BE-në, dëshiron që me

E ardhmja evropiane e Kosovës, proces i pakthyesëm

Kosova duhet ta lë pas të kaluarën dhe të fokusohet për përshpejtimin e procesit të integritimit në Bashkimin Evropian. Kështu kanë deklaruar të mërkurën ambasadorja e Kroacisë në Kosovë, Marija Kapitanoviç, shefja e Zyrës Ndërlidhëse të Greqisë, ambasadorja Konstantina Athanasiadou, si dhe ambasadori i Shqipërisë, Qemal Minxhozi

PRISHTINE, 14 SHKURT (ER) - Të gjitha shtetet evropiane e kanë të ardhmen e përbashkët, përfshirë edhe Kosovën, prandaj Kosova duhet ta lë pas të kaluarën dhe të fokusohet për përshpejtimin e këtij procesi. Kështu është thënë të mërkurën në tryezën "Strategjia e Zgjerimit: Bashkëpunimi rajonal si një faktor kyç për të ardhmen evropiane të Ballkanit Perëndimor" e organizuar nga Instituti i UBT-së për Politikë dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare me rastin e 10-vjetorit të pavarësisë së Kosovës.

Ambasadorja e Kroacisë në Kosovë, Marija Kapitanoviç, ka thënë se procesi nëpër të cilin po kalon Kosova është sfidues dhe duhet bërë shumë punë si dhe nevojitet angazhim më i madh politik që të arrihet deri tek rezultatet. "Pika e parë në të cilën Kosova duhet të punojë është harmonizimi i legjislacionit dhe implementimi i tij, si dhe përshtatja e tyre me kërkesat dhe nevojat e BE-së. Sa më shumë marrëveshje të implementohen, vendi mund të lëvizë përpara drejt procesit të integritimit", ka deklaruar

Kapitanoviçi. Sipas saj, për zbatimin e reformave për integritim në BE, Kosova duhet ta ndjekë shembullin e Kroacisë, në vitet kur të gjitha partitë politike kroate i kishin lënë anash të gjitha dallimet dhe kanë bërë konsensus për të punuar të gjithë së bashku për përshpejtimin e procesit të integritimit.

Ndërsa shefja e Zyrës Ndërlidhëse të Greqisë në Kosovë, ambasadorja Konstantina Athanasiadou, ka thënë se nuk duhet lejuar që dallimet politike ta turbullojnë vizionin e vendeve të Ballkanit për një të ardhme të përbashkët në Bashkimin Evropian. "Ne e kemi një të ardhme të përbashkët, por duhet të negociojmë dhe negociatat në të shumtën e rasteve janë të vështira. Megjithatë, çështjet e ashtuquajtura të hapura kanë nevojë për negociim dhe finalizim, në mënyrë që të arrihet deri tek rezultatet", është shprehur Athanasiadou.

Kurse ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi, ka vlerësuar se vonimi i secilit proces është veprim i dëmshëm prandaj, sipas tij,

zvarritjet janë të pakuptimta dhe e ndalojnë përparimin e Kosovës. "Sa më tepër që zvarritet procesi i afrimit me BE-në aq më tepër do të vuajmë në aspektin ekonomik. Por, për tejkalimin e këtyre vështirësive, rol të madh mund të luajë edhe elita akademike. Bota akademike duhet të lëvizë në hapa dhe studime konkrete drejt BE-së. Kjo organizatë është e ardhmja jonë e padiskutueshme dhe përdërisa Ballkani Perëndimor nuk është pjesë, BE-ja mbetet proces dhe projekt i papërfunduar", ka theksuar Minxhozi.

Ndërkaq rektori i UBT-së, Edmond Hajrizi, ka thënë se secili duhet të ketë obligim dhe përgjegjësi të ofrojë kontribut për ta përafuar vendin me Bashkimin Evropian. "E ardhmja evropiane e Kosovës është një aspiratë e gjithë shoqërisë së Kosovës, prandaj edhe strategjia e re për zgjerim e Bashkimit Evropian duhet të duartrokitet për artikullimin e një vizioni që parasheh për vendin tonë dhe të gjithë rajonin brenda Bashkimit Evropian", është shprehur Hajrizi.



Delegacioni i BE-së interesohet për zbatimin e agjendës evropiane të Kosovës

PRISHTINË, 14 SHKURT (ER) - Një delegacion i Bashkimit Evropian, i kryesuar nga drejtori gjeneral i Komisionit Evropian për Fqinjësi dhe Negociata për Zgjerim, Christian Danielsson, dhe drejtori menaxhues për Evropë dhe Azi Qendrore në Shërbimin Evropian për Punë të Jashtme (EEAS), Thomas Mayr-Harting, kanë ardhur për vizitë në Kosovë. Ky delegacion është pritur në një takim nga kryeministri Ramush Haradinaj dhe min-

istrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, dhe ministri i Drejtësisë Abelard Tahiri. Në konferencën e përbashkët pas takimit, kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se temë kryesore e takimit ishte perspektiva evropiane e Kosovës, zbatimi i agjendës evropiane për Kosovën dhe synimet e Kosovës në këtë rrugë. "Strategjia për Ballkanin Perëndimor e ka lënë rrugën hapur për Kosovën dhe e ka definuar këtë rrugë, por na mbetet shumë punë për të

bërë", ka thënë Haradinaj. Edhe përfaqësuesit e BE-së, drejtorët Danielsson dhe Mayr-Harting, theks të veçantë i kushtuan Strategjisë për Ballkanin Perëndimor, në të cilën përfshihet edhe Kosova. Të dy përfaqësuesit e BE-së theksuan se kjo vizitë zhvillohet pas një jave të publikimit të Strategjisë për Ballkanin Perëndimor, e cila e qartëson perspektivën evropiane për të gjithë Ballkanin Perëndimor, përfshirë edhe Kosovën.



GAP-i: Mandatin e kaluar kryetarët e komunave përmbushën gjysmën e premtimeve

EPOKA E ENJTE Faton DERMAKU

PRISHTINË, 14 SHKURT - Përfaqësuesit e Institutit GAP kanë mbajtur të mërkurën konferencë për media, në të cilën kanë prezantuar platformën elektronike e cila përmban të gjitha premtimet e dhëna nga kryetarët e komunave në zgjedhjet e fundit lokale 2017. Instituti GAP ka konstatuar se janë përmbushur 55 për qind e premtimeve të kryetarëve të komunave në mandatin e kaluar. "Në mandatin e kaluar numri i premtimeve të dhëna nga kryetarët e komunave ka qenë më i vogël. Gjithsejtë kanë qenë 548 premtime të dhëna në mandatin e kaluar. Nëse flasim për rezultatet e tyre, 243 premtime janë përmbushur plotësisht. Diku 55 % të premtimeve janë përmbushur plotësisht", ka thënë Bekim Salihu, hulumtues i Institutit GAP. Salihu ka treguar se gjatë

fushatës për zgjedhje lokale 2017 kryetarët e tanishëm të komunave kanë dhënë gjithsej 888 premtime. "Numri më i madh i premtimeve është dhënë në fushën e infrastrukturës me gjithsejtë 333 premtime, pastaj vjen fusha e arsimit me 126 premtime dhe fusha e shërbimeve publike me 100 premtime. Komunitat me numrin më të madh të premtimeve janë Viti, Prishtina dhe Gjakova", ka thënë Salihu.

Jeton Mehmeti, drejtori i hulumtimeve në Institutin GAP, ka shpjeguar metodologjinë e hulumtimit dhe vlerësimit të përmbushjes së premtimeve. Sipas tij, premtimet janë nxjerrë nga programet zgjedhore të kandidatëve dhe nga debatet televizive. "Disa nga kryetarët aktualë nuk kanë zhvilluar fushatë elektorale, prandaj edhe ka qenë e pamundur të evidentohet ndonjë premtim zgjedhor", ka thënë ai.

Mehmeti ka bërë me dije se Instituti GAP do ta bëjë moni-




torimin dhe vlerësimin e përmbushjes së premtimeve të kryetarëve në mënyrë periodike në

katër vjetët e ardhshëm. Instituti GAP edhe në mandatin e kaluar ka monitoruar përmbushjen

e premtimeve, ku nga 548 premtime të dhëna, vetëm 283 premtime ishin përmbushur plotësisht.

Presidenti Thaçi pranoi letrat kredenciale nga ambasadorja e re e Panamasë



PRISHTINË, 14 SHKURT (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka pranuar të mërkurën letrat kredenciale nga ambasadorja e re jorezidente e Panamasë për Republikën e Kosovës, Paulina Franceschi Navarro. Presidenti Thaçi e ka uruar atë për detyrën e re, duke i ofruar përkrahje të plotë për ushtrimin e postit të saj. "U jemi mirënjohës dhe falënderues për njohjen që Panamaja i ka bërë Kosovës, por edhe për mbështetjen e vazhdueshme që keni dhënë për fuqizimin e subjektivitetit ndërkombëtar", ka thënë presidenti. Nga ana tjetër, ambasadorja

jorezidente e Panamasë për Kosovën, Paulina Franceschi Navarro, duke e falënderuar presidentin Thaçi, i shprehu urimet më të mira për 10-vjetorin e pavarësisë. Kreu i shtetit në fund ka thënë se Panamaja është partnere strategjike në Amerikën Latine, duke theksuar nevojën për rritjen e bashkëpunimit bilateral ndërmjet dy shteteve. Po ashtu, presidenti Thaçi të mërkurën ka pranuar letrat kredenciale edhe nga ambasadori i ri jorezident i Emirateve të Bashkuara Arabe për Republikën e Kosovës, Abdulasam Hareb Obaid Al Romaithi.

Mësimdhënësit mbajnë grevë njëorëshe në gjithë Kosovën

SBASHK-u 'kërcënon' sërish me grevë nëse nuk realizohen kërkesat

Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), Rrahman Jasharaj, ka thënë se në grevën njëorëshe të mërkurën i tërë procesi arsimor ishte unik. Jasharaj ka thënë se nëse nuk realizohen kërkesat, SBASHK-u është i vendosur t'i vazhdojë veprimet sindikale. Ndërkaq kryeministri Ramush Haradinaj ka premtuar se do të punojë për realizimin e kërkesave të SBASHK-ut

**EPOKA
ERE**

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 14 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije të mërkurën se gjatë ditëve të ardhshme do t'i takojë përfaqësuesit e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) për të gjetur një zgjidhje lidhur me kërkesat e tyre. Paralajmërimi për këtë takim ka ardhur si rezultat i grevës njëorëshe të mësimdhënësve në gjithë Kosovën. Haradinaj ka premtuar se bashkë me përfaqësuesit e SBASHK-ut do të punojë në trajtimin e kërkesave me qëllim të realizimit të tyre si dhe për përmbushjen e obligimeve shtetërore. "Duke marrë parasysh sakrificën e të gjitha segmenteve të shoqërisë sonë, Qeveria e Kosovës ishte dhe mbetet e përkushtuar t'i trajtojë me prioritet kërkesat dhe nevojat e të gjitha kategorive të lirisë. Tashmë një pjesë e këtyre kategorive kanë mbështetjen e plotë ligjore. Në këtë frymë të përkushtimit, njohja e sakrificës së mësimdhënësve të viteve të

'90-ta ka një rëndësi të veçantë. Mësimdhënësit e viteve të '90-ta ishin shtylla e papërkulur e rezistencës sonë. Gjatë ditëve në vijim do t'i takoj përfaqësuesit e SBASHK-ut dhe bashkërisht me ta do të punojmë për trajtimin e kërkesave me qëllim të realizimit të tyre, por edhe për përmbushjen e obligimeve tona si shtet", ka thënë kryeministri Haradinaj. Ndërkaq kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, ka thënë se në grevën njëorëshe i tërë procesi arsimor ishte unik. Ai ka thënë se udhëheqja e SBASHK-ut do të jetë këmbëngulëse dhe e pa luhatur në angazhimet e saj për përmbushjen e kërkesave për mësimdhënësit e viteve të '90-ta.

Jasharaj ka vizituar të mërkurën disa shkolla në Komunën e Prishtinës dhe Prizrenit, ku nga afër ka marrë kërkesat e mësimdhënësve nga ato shkolla. "Nga të dhënat që kemi marrë nga këshillat greviste komunale dhe ato të universiteteve, shihet se të gjitha institucionet arsimore që janë anëtare të SBASHK-ut kanë qenë në grevën njëorëshe të ndërrimit të paradites dhe pasdites. Vlen të



theksojmë se edhe një pjesë e mirë nga ato pak shkolla që ende nuk janë anëtare të SBASHK-ut i janë bashkangjitur grevës sonë", ka thënë ai. Jasharaj i ka bërë edhe një herë thirrje publike kryeministrit Ramush Haradinaj dhe kryetarit të Kuvendit, Kadri Veseli, që t'i përmbushin obligimet që i kanë marrë me rastin e nën-

shkrimit të marrëveshjes me SBASHK-un në mënyrë që gjendja në arsim të jetë e qetë. "Të angazhohemi të gjithë për një arsim edhe më të mirë në Kosovë", është shprehur Jasharaj. Ai ka thënë se nëse nuk realizohen kërkesat, SBASHK-u është i vendosur t'i vazhdojë veprimet sindikale. "Kongresi i SBASHK-ut është ai

që do të marrë vendim për veprime edhe më radikale sindikale, përmes protestave publike dhe përmes grevës së përgjithshme deri në realizimin e kërkesave tona. Institucionet këtë mos ta kuptojnë si kërcënim, por si ftesë korrekte dhe veprim ligjor të SBASHK-ut për realizimin e kërkesave", ka thënë Jasharaj.

OVLUÇK-ja: Të mos nëpërkëmben as flamuri kombëtar e as ai shtetëror

PRISHTINË, 14 SHKURT (ER) - Organizatat e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kanë uruar qytetarët për dhjetëvjetorin e pavarësisë së Kosovës. Organizatat e dala nga lufta përmes një komunikate për medie kanë reaguar edhe për ngjarjet e fundit politike në vend. "Ngjarjet që janë duke ndodhur në këtë përvjetor të pavarësisë, duke i vendosur përballë flamurin kombëtar dhe flamurin shtetëror, kanë pasojë negative për shoqërinë tonë. Pavarësia e Kosovës ka ardhur si rezultat i përpjekjeve të shumë gjeneratave e që u kurorëzua me luftën çlirimtare, në të cilën morën pjesë shqiptarët nga

të gjitha trojet e tyre. Ndërsa flamuri kombëtar është pjesë e historisë dhe përpjekjeve tona, e që ishte edhe në ballë të luftës sonë çlirimtare dhe element i aktit të betimit të UÇK-së", është theksuar në komunikatën e OVLUÇK-së. Organizatat e dala nga lufta kanë bërë me dije se janë kundër heqjes së flamurit kombëtar, por edhe kundër heqjes së atij shtetëror. "Me këtë rast kërkojmë nga institucionet dhe partitë politike të mos i nëpërkëmbin asnjërin nga këta flamuj, aq më tepër që ata të zhvendosen natën. Pavarësia e Kosovës duhet të jetë ditë që na bashkon e jo ditë që na përçarë", është thënë në komunikatën e OVLUÇK-së.




Suedia do ta ndihmojë Kosovën me projekte të ndryshme

PRISHTINË, 14 SHKURT (ER) - Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka pritur të mërkurën në takim të ngarkuarin me punën e ambasadorit të Mbretërisë së Suedisë për Kosovën, Anders Wollter, me të cilin ka diskutuar për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve, në veçanti në fushën e financave dhe regjistrimit të pronave. Me këtë rast, ministri Hamza ka falënderuar Anders Wollterin për ndihmën dhe kontributin e tij dhe të shtetit suedez që kanë dhënë dhe vazhdojnë ta japin për institucionet e Kosovës, për projektet që financohen nga shteti suedez, në veçanti për projektin "Protax2" që është në kuadër të Departamentit të Tatimit në Pronë në Ministrinë e Financave.

Po ashtu, ministri Hamza ka

njoftuar ambasadorin suedez edhe me procesin e përfundimit të miratimit të ligjit të ri të tatimit në pronë nga Kuvendi i Kosovës si dhe për fillimin e përgatitjeve të udhëzimeve administrative që derivojnë nga Ligji për falje. Ndërsa i ngarkuari me punën e ambasadorit të Mbretërisë së Suedisë për Kosovën, Anders Wollter, e ka falënderuar ministrin Hamza për pritjen dhe ka shprehur gatishtërinë e shtetit të tij për zgjerimin e bashkëpunimit ekonomik me Kosovën. Ai e ka njoftuar ministrin Hamza se shteti suedez ka marrë vendim për nënshkrimin e marrëveshjes që përmes SIDA-s dhe Agjencisë së Taksave të Suedisë ta vazhdojë projektin për Kosovën "Protax2" deri në vitin 2020, e cila marrëveshje pritet të nënshkruhet së shpejti.



ATK-ja për 18 vjet inkasoi 5.2 miliardë euro



Drejtori i përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Sakip Imeri, ka thënë se të hyrat e inkasuara të këtij institucioni përgjatë 18 vjetëve kanë arritur vlerën 5.2 miliardë euro

EPOKA E RE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 14 SHKURT - Drejtori i përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Sakip Imeri, ka mbajtur të mërkurën konferencë për medie, në të cilën ka bërë një rezymë të punës dhjetëvjeçare të këtij institucioni. Imeri ka bërë me dije se për 18 vjet ATK-ja ka inkasuar 5.2 miliardë euro. "Përgjatë këtyre viteve ATK-ja ka arritur të jetë institucion i konsoliduar i të gjitha reformave që kanë ndodhur në Kosovë. ATK-ja gjatë këtyre 18 vjetëve ka filluar tatimin në hotele, fillimisht në vitin 2000, për të vazhduar më tutje me ngritjen e kapaciteteve me 574 milionë euro të realizuara. Për 18 vjet ATK-ja ka inkasuar 5.2 miliardë euro", ka thënë Imeri. Sipas tij, viti 2018 ka filluar mbarë për ATK-në. "Viti 2018 është vit që ka filluar mbarë për ATK-në, nga 48,8 milionë euro të hyra të parashikuar apo 5.3 % më shumë se plani ynë, kurse 14 % më shumë se viti i kaluar", ka thënë ai.

Pos të tjerash, Imeri ka thënë se Ligji për faljen e borxheve ka treguar performancë pozitive, pasi në këtë drejtim kanë përfutur bizneset si dhe arka e shtetit. "Ligji për faljen e borxheve ka sjellë rezultate pozitive si për shtetin, po ashtu edhe për bizneset, pasi filluam me një fillim të barabartë. Në saje të këtij ligji dhe marrëveshjes me biznese, ne kemi arkëtuar 35 milionë euro", është shprehur Imeri.

Ai ka folur dhe për rimbursimin e kuponëve fiskalë.

Imeri ka treguar se për rimbursimin e kuponëve fiskalë për dy vjet kanë aplikuar mbi 1 milion e 523.792 qytetarë dhe, sipas tij, është rimbursuar vlera mbi 28 milionë euro. I pyetur nga gazeta për operimin e ATK-së në veri të Mitrovicës, Imeri ka thënë se mbi 13 % e të hyrave në Mitrovicë janë nga komunat veriore. "Në veri jemi duke operuar mirë pasi mbi 13 % e të hyrave në Mitrovicë janë nga katër komunat veriore", ka thënë Sakip Imeri, drejtor i përgjithshëm i ATK-së.

'Al Petrol'-i nderohet me mirënjohje nga shteti

PRISHTINË, 14 SHKURT - Në prag të 10-vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës, "AL Petrol"-i ka marrë mirënjohje për kontributin e dhënë në zhvillimin ekonomik të vendit. Këtë çmim "AL Petrol"-i e ka pranuar nga presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi. "Vlerësimi që na u dha nga presidenti i Kosovës, z. Thaçi, është një shtytje shtesë që të ecim përpara. Duke u zhvilluar kompanitë e duke u zhvilluar ekonomia, shteti ynë i ri do të jetë aq më shumë i fuqishëm. Andaj dua të besoj se

nuk do të ndalemi së punuari sepse vetëm me punë do të ecë shteti përpara", u shpreh presidenti i "AL Petrol"-it, Latif Kryeziu.

Ai ka shtuar se "AL Petrol"-i vazhdon të angazhohet që qytetarëve të Republikës së Kosovës t'u ofrojë shërbime dhe produkte të standardeve më të larta botërore. Së fundmi, "AL Petrol"-i ka nënshkruar kontratë me kompaninë më të madhe për derivate në botë, kompaninë "Shell", e që shumë shpejt do të ribrendohen pikat me këtë emër.



Zhang: Kosova duhet t'i vazhdojë reformat për rritje më të madhe ekonomike



Zëvendësdirigjenti menaxhues i Fondit Monetar Ndërkombëtar, Tao Zhang, ka thënë se Kosova duhet të shënojë rritje edhe më të madhe ekonomike për t'i përmbushur aspiratat që ka në sektorin e zhvillimit ekonomik

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 14 SHKURT - Zëvendësdirigjenti menaxhues i Fondit Monetar Ndërkombëtar, Tao Zhang, është pritur të mërkurën në takim nga ministri i Financave, Bedri Hamza dhe ushtruesi i detyrës së guvernatorit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti. Me këtë rast, ministri Hamza ka falënderuar Zhang për mbështetjen e FMN-së dhe

angazhimin që ky institucion po jep për Kosovën. "Siç jeni njoftuar, para dy javëve Bordi Ekzekutiv i FMN-së, i kryesuar nga z. Zhang, ka aprovuar rishikimin vjetor të gjendjes ekonomike dhe fiskale në Kosovë (Rishikimi i Artikullit të IV). Me këtë rast, Bordi ka diskutuar rreth zhvillimeve ekonomike në Kosovë për vitin 2017 dhe drejtorët ekzekutivë janë pajtuar njëzëri se Kosova ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për forcimin e

qëndrueshmërisë fiskale, forcimin e stabilitetit në sektorin financiar, si dhe për avancimin e reformave strukturore", ka thënë Hamza. Edhe ushtruesi i guvernatorit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka thënë se do të vazhdojnë të jenë partner i besueshëm i FMN-së duke punuar në mënyrë intensive për zbatimin e reformave të mëtejme strukturore. "Do të vazhdojmë ta forcojmë edhe më tutje bashkëpunimin e shkëlqyeshëm ndërmjet dy institucioneve. Zhvillimet në sektorin bankar janë shumë të favorshme edhe sa iu përket treguesve të shëndetit financiar. Dëshiroj ta theksoj rënien e mëtejme të normës së kredive joperformuese, e cila tani ka zbritur në 3.1%", ka thënë Mehmeti.

Ndërsa zëvendësdirigjenti

menaxhues i Fondit Monetar Ndërkombëtar, Tao Zhang, ka falënderuar ministrin Bedri Hamza dhe ushtruesin e detyrës së guvernatorit të BQK-së, Fehmi Mehmeti, për bashkëpunimin e shkëlqyer dhe të sinqertë të Kosovës me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Ai ka shprehur vullnetin dhe gatishmërinë e FMN-së për ta mbështetur zhvillimin e mëtutjeshëm ekonomik të Kosovës. Zhang ka shtuar se Kosova duhet të shënojë rritje edhe më të madhe ekonomike për t'i përmbushur aspiratat që ka në sektorin e zhvillimit ekonomik. "Në këtë kontekst duhet të ketë punësim të rinisë. Kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme për Kosovën. Duhet t'i vazhdoni reformat në arsim dhe në ambientin e biznesit, në mënyrë që të krijohen vende të reja të punës", ka thënë Zhang.

Zëvendësdirigjenti menaxhues i Fondit Monetar Ndërkombëtar, Tao Zhang, është takuar të mërkurën edhe me kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli dhe kryeministrin Ramush Haradinaj. Veseli e ka falënderuar FMN-në për mbështetjen që ia ka dhënë dhe po i jep Kosovës. Më tutje, Veseli ka folur për nevojën e fuqizimit të mëtutjeshëm të sektorit privat, i cili kontribuon shumë në progresin ekonomik të vendit tonë dhe mirëqenien e qytetarëve tanë. Kryeministri Haradinaj ka thënë se Kosova do të vazhdojë ta ruajë partneritetin konstruktiv me FMN-në. "Kosovës i duhet në vazhdimësi mbështetje nga FMN-ja për arritjen e objektivave makro-financiare, siç do të vazhdojmë të jemi përgjegjës për rolin tonë", ka thënë Haradinaj.

Dogana sot nis implementimin e sistemit ASYCUDA World

PRISHTINË, 14 SHKURT (ER) - Dogana e Kosovës ka njoftuar të gjitha subjektet, ato importuese, eksportuese, transportuesit e mallrave, agjentët doganorë dhe palët e tjera që zhvillojnë aktivitetet në tregtinë ndërkombëtare, se sot (e enjte), duke filluar nga ora 18:00, Dogana e Kosovës do ta fillojë implementimin e versionit të ri të sistemit ASYCUDA World

(AW).

Sipas njoftimit të Doganës, versioni i ri që do të instalohet ofron mundësi më të mëdha në procedurat doganore, lehtësira si dhe siguri në procedura doganore. "Për të përditësuar këtë sistemim duhet të ndërpritet sistemi aktual dhe koha e nevojshme për të kaluar në versionin e ri është rreth gjashtë (6) orë, prandaj është

planifikuar që më 15 shkurt 2018, duke filluar nga ora 18:00 - 24:00, të kalohet në versionin e ri të sistemit ASYCUDA (AW). Gjatë kësaj kohe prej gjashtë orëve mund të ketë vonesa në vendkalime kufitare dhe pritje më të gjata, prandaj kërkohet mirëkuptimin tuaj për çdo vonese eventuale gjatë kësaj kohe", është bërë me dije në njoftimin e Doganës.



Ministri Lekaj premton përkrahje për Shtimen dhe Ferizajn

SHTIME, 14 SHKURT (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka vizituar të mërkurën Komunën e Shtimes, ku është pritur në takim nga kryetari i kësaj komune, Naim Ismajli. Lekaj e Ismajli kanë diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Komunës së Shtimes.

Ministri Lekaj e ka siguruar kryetarin Ismajli se Ministria e Infrastrukturës do ta përkrahë Komunën e Shtimes sikurse edhe komunat e tjera të vendit. Lekaj ka thënë se kjo komunë do ta ketë vëmendjen e duhur të ministrisë dhe se do të përkrahjet



fuqishëm në projektet infrastruktururore.

Ndërsa kryetari i Shtimes, Naim Ismajli, e ka falënderuar min-

istrin Lekaj për mbështetjen dhe ka theksuar rëndësinë e bashkëpunimit të komunave me institucionet qendrore. Pas këtij



takimi, ministri Pal Lekaj ka vizituar edhe Komunën e Ferizajt, ku është takuar me kryetarin e kësaj komune, Agim Aliu. Gjatë

këtij takimi, Lekaj e Aliu kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për projektet infrastruktururore të Ferizajt.

Kryetari Bahtiri priti në takim përfaqësues të UN-Habitatit



MITROVICË, 14 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, dhe drejtori i Urbanizmit, Sami Zeka, kanë pritur të mërkurën në takim Gwendoline Mennetrier, përfaqësuese e UN-Habitat, me të cilën ka biseduar për dy projekte që janë duke u realizuar në Mitrovicë, ai i Planit Zhvillimor Komunal (PZH) dhe hartimi i

hartave zonale. Me këtë rast, kryetari Bahtiri e ka falënderuar zyrtaren e UN-Habitatit për përkrahjen e kësaj zyre për hartimin e PZhK-së. "Hartimi i PZhK-së është një punë e madhe, por që frytet e saj do të shihen në të ardhmen", ka thënë Bahtiri. Ndërsa Mennetrier, duke lavdëruar PZhK-në, ka thënë se Mitrovica ka bërë një

punë shumë të mirë me hartimin e planit zhvillimor komunal në përputhshmëri me ligjin për planifikimin hapësinor si dhe për hartimin e hartave komunale zonale. Ajo e ka ftuar kryetarin Bahtiri dhe grupin punues për një vizitë në Toronto të Italisë, ku do të shkëmbehen përvoja lidhur me funksionimin e tregjeve urbane.

Asamblistët e PDK-së në Skenderaj u kthehen seancave

SKENDERAJ, 14 SHKURT - Pas disa seancash bojkoti, asamblistët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Komunën e Skenderajt janë kthyer përsëri në Kuvend. Njëpërmjet një komunikate për medie, Dega e PDK-së në Skenderaj ka bërë me dije se janë

kthyer në seancë me një kërkesë të vetme, mosvazhdimin e saj me gabime.

Grupi parlamentar i asamblistëve të PDK-së në Kuvendin Komunal të Skenderajt i është drejtuar me një deklaratë kryetarit të kësaj komune, Bekim

Jasharit, lidhur me shpalljen e interesit të përgjithshëm për themelimin e një zone ekonomike mbi pronësinë e menaxhuar nga AKP-ja. Sipas grupit parlamentar të PDK-së, kjo përbën shkelje ligjore pasi propozimi ka paqartësi dhe është

i mangët. "Ne nuk dimë ku gjenden ato prona të komunës për këmbim. A ka komuna një sipërfaqe prej 30 hektarësh për këmbim dhe cila do të jetë afërsisht vlera e këtyre pronave", është thënë në komunikatën e Degës së PDK-së në Skenderaj.



MAPL-ja përkrah Komunën e Kllokotit



Kllokot, 14 shkurt (ER) - Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Ivan Todossijeviq, ka vizituar Komunën e Kllokotit, me ç'rast është takuar me kryetarin e kësaj komune, Bozidar Dejanoviq. Ministri Todossijeviq i ka uruar fat kryetarit të ri të komunës, duke

cekur se prioritet për të janë qytetarët e kësaj komune. "Sa më shumë vëmendje t'u kushtohet kërkesave dhe nevojave të qytetarëve. MAPL-ja sikur deri më tani me kapacitet të plotë në përputhje me mundësitë e saj do të përkrahë këtë komunë", ka thënë Todossijeviq.

Ndërsa kryetari i Komunës së Kllokotit, Bozidar Dejanoviq, ka falënderuar ministrin Todossijeviq për vizitën dhe shkurtimisht e ka informuar për punën në komunë, problemet me të cilat ballafaqohet komuna si dhe për planet dhe idetë të cilat komuna në të ardhmen

mund t'i realizojë në mënyrë që të kontribuojë në jetën e qytetarëve. Ministri së bashku me kryetarin e komunës kanë vizituar Shtëpinë e Kulturës në Kllokot dhe qendrën e fshatit Vërbovc, ku MAPL-ja do ta financojë projektin për rregullimin e qendrës së fshatit.

Aliu premton kujdes institucional për personat me nevoja të veçanta

Ferizaj, 14 shkurt (ER) - Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka pritur të mërkurën në takim përfaqësuesit e shoqatave të personave me nevoja të veçanta në Ferizaj, përkatësisht drejtuesit e Shoqatës "Handikos" dhe Shoqatës "Hendifer". Në këtë takim

është diskutuar për një varg çështjesh që shqetësojnë këtë komunitet, me theks të veçantë për zbatueshmërinë e ligjit për këtë kategori shoqërore dhe kompetencat e komunave për trajtimin e nevojave të këtij komuniteti. Aliu ka siguruar drejtuesit e shoqatave të personave me

nevoja të veçanta se në mandatin e tij qeverisës kjo kategori shoqërore do ta ketë mbështetjen e nevojshme institucionale si dhe vendim-marrjen e përbashkët në çështjet që preokupojnë këtë komunitet. Ndërsa drejtuesit e shoqatave të personave me

nevoja të veçanta, duke uruar kryetarin Aliu për këtë mandat qeverisës, kanë theksuar se bashkëpunimi i këtyre shoqatave me institucionin e komunës është themelor për avancimin e të drejtave dhe mundësive që burojnë nga ligji përkatës për këtë kategori shoqërore.

Vizioni i kryetarit Aliu për këtë komunitet është realizimi i projekteve konkrete në përmbushje të zotimit të tij për kujdes të shtuar institucional dhe mbështetje reale ndaj kategorive të ndryshme shoqërore, në këtë rast komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

"MENDIME TË ZGJEDHURA PËR ADEM DEMAÇIN" (6)

ADEM DEMAÇI, VIGAN I POPULLIT SHQIPTAR



Selatin NOVOSILLA

109. Hysen Neziri, profesor: Adem Demaçi të zgjedhet kryetar i Kuvendit të Kosovës. Ideja që Adem Demaçi të zgjedhet deputet, e nëse zgjedhet deputet do të bëhet edhe kryetar i Kuvendit të Kosovës, është sa e qëlluar, aq e domosdoshme. Sigurisht Adem Demaçi do të përpjetet të ndjekë një politikë më aktive në krahasim me politikën e sotme të Presidentit Ibrahim Rugova.

110. Ibish Neziri, bashkëvuajtës i Adem Demaçit në Burgun e Stara Gradishkës: Adem Demaçi, optimist i papërmirësueshëm. Adem Demaçi është mësues i mrekullueshëm, optimist i papërmirësueshëm dhe vizionar largpamës, në kuptimin e plotë të fjalës. Ai, edhe pse u gjend si në llumin e burgjeve tjera edhe në llumin e Stara Gradishkës, nuk e njollosi me asgjë dinjitetin e tij dhe të popullit që i priu, por atë me gjithçka e ngriti në pedestalin më të lartë.

111. Ibrahim Gashi, bashkëveprimtar i Adem Demaçit: Adem Demaçi, dy herë udhëheqës i shqiptarëve të Kosovës. Kur i kemi ngritur 40 flamuj kombëtarë në Prishtinë, në muajin qershor 1964, së bashku me Selatin Novosellën, Shemi Hoxhën dhe Skënder Havollin, kemi vendosur nga një flamur në dyert e të burgosurve politikë, ndërsa në derën e shtëpisë së Adem Demaçit, i kemi vendosur dy flamuj. Në këtë mënyrë dëshironim t'ia bënim me dije pushtetit jugosllav se - nëse Adem Demaçi ishte njëherë udhëheqësi ynë, tashti, pas burgosjes së tij, ai ishte dy herë udhëheqësi ynë.

112. Ibrahim Gashi, rektor i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina": Adem Demaçi, disidentin më i rëndësishëm në Jugosllavi. Adem Demaçi, si një intelektual i ri dhe si një nga disidentët më të rëndësishëm në Jugosllavi, përmes Programit të organizatës atdhetare "Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve", në vitin 1964, kishte shprehur pikëpamjet dhe analizën e tij mbi zhvillimet ndërkombe të luftës së ftohtë.

113. Ibrahim Rugova, president i Republikës së Kosovës: Adem Demaçi, letrar i harmonisë shqiptare e njerëzore. Adem Demaçi është letrar i harmonisë shqiptare e njerëzore, humanist i madh. Themë kështu, ngase shkrimtari, me veprën e vet

"Gjarpinjtë e gjakut" ka dashur të flakë dhe të zhdukë një veti të keqe të popullit të vetëhakmarrjen. Një vizion po ashtu të ndrihtëm të romanit e përjetojmë edhe sot kur, sikur në antikën greke e ilire, shqiptarët i falin gjaqet, i mbysin gjarpinjtë e gjakut dhe pajtohen. Sot, gati të gjithë, jemi bërë protagonistë të romanit tuaj.

114. Ibrahim Shala, zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në ekzil: Adem Demaçi në mendimet e tij politike është shumë original dhe i pavarur. Ajo që e bën të veçantë Adem Demaçin nga të tjerët është fakti, se në mendimet e tij politike është shumë origjinal dhe i pavarur, duke mos iu nënshtruar ndikimit të asnjë autoriteti që nuk përputhet me konceptet e tij politike. Adem Demaçi është një jetë të tërë në shërbim të Kosovës. Ai dhe Kosova janë bërë një.

115. Idriz Ajeti, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës: Adem Demaçi ka një përvojë të çmuar politike. Vepra e Adem Demaçit do të shikohet, do të këqyret detyrimisht edhe nga një dimension tjetër, nga pikëpamja e tij shoqërore. Thamë detyrimisht për arsye se Demaçi, sikundër dihet, në rrymë të disa dekadave vepruese të tij ka akumuluar përvojë të çmuar politike, të shumtën duke u dergur nëpër burgje e kazamate të socializmit jugosllav i cili po ngehte pretendime të krijonte parajsë tokësore.

116. Idriz Mehmeti, ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: S'kishte forcë që ta ndalte ortekun e nisur nga Adem Demaçi. Ndonëse rinia studentore po kositej nga dora vrashtarë serbe dhe burgjet po mbusheshin me të rinj e të reja, s'kishte fuqi ta ndalte ortekun e nisur nga bijat dhe bijtë e popullit tonë të frymëzuar nga Baca Adem Demaçi.

117. Idriz Zeqiraj, veprimtar i çështjes kombëtare: Adem Demaçi shtroi kërkesa largpamëse në organizatën "Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve". Baca Adem, duke qenë i njohur me kërkesat e organizatës tuaj, "Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve", e para organizatë aq numerike në Kosovë, unë me shokë shtruam kërkesat në rrugë legale, publike: Flamurin kombëtar, Universitetin e Prishtinës, Autonomi për Kosovën - me aludimin e hapur për Republikë dhe për bashkimin më të ngushtë me Shqipërinë Nënë.

118. Ilii Ramadan, veprimtar i njohur i çështjes kombëtare: Adem Demaçi thërriste për çlirim dhe bashkim kombëtar. Adem Demaçin nuk e njoha nga larg, as nëpërmjet të tretit, po nga afër, ballafaqas. Nuk e njoha, si shumica, pas vuajtjes së burgjeve, por me kohë, atëherë kur thërriste që t'i bashkoheshim në luftën e drejtë për liri, për çlirim e bashkimin kombëtar.

119. Imer Xhemal Lladrovci,

veprimtar i çështjes kombëtare: Adem Demaçi refuzon anëtarësimin në Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë. Intelektualit Adem Demaçi, si pothuajse të gjithë intelektualëve të rinj kosovarë në vitet e '50-ta, i propozohet të bëhet anëtar i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë. Ndrishte nga të tjerët që donin të bënin karrierë profesionale dhe politike, Adem Demaçi refuzoi të bëhet anëtar i kësaj partie.

120. Imzot Nikë Prella, kryepeshkë i Ipeshkëvisë së Kosovës: Adem Demaçi, Krishti i shqiptarëve. A e keni parë ju Krishtin ndonjëherë? Ja, ky burrë, Adem Demaçi, është Krishti vetë! Çka ka bërë Krishti më tepër se ky? 28 vjet në burg i mbajti ky burrë. Të numërosh deri në 28 është shumë, e jo më 28 vite t'i mbash burg!

121. Isa Vatovci, gazetar: Adem

veçanta për shumë fusha të angazhimeve të tij. Për Adem Demaçin duhet të shkruhen apo mbetet obligim i së ardhmes, të bëhen shkrime të gjera analitike, të shkruhen vepra të ndara për Adem Demaçin si veprimtar atdhetar dhe i burgosur politik, për Demaçin si letrar, romancier dhe tregimtar, për Adem Demaçin si gazetar, publicist, analist dhe personalitet politik dhe publik.

125. Ismail Kadare, shkrimtar: Adem Demaçi, shembull i lirisë. Ju, i dashur Adem, jeni shembull për të gjithë intelektualët shqiptarë e evropianë. Ju jeni shembull i lirisë, për të cilën sot flitet aq shumë, e për të cilën për fat të keq bëhet aq pak. Por, nëpërmjet akteve si ky Juaji, liria e fiton kuptimin e saj.

126. Ismail Kastrati, kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës: UDBA dhe Komiteti ishin të sigurt vetëm kur Adem Demaçi ishte prapa grilave. Adem Demaçi, ndonëse i kishte vuajtur 13 vite burg, përsëri Komiteti dhe UDB-ja e ndienin më të sigurt vetëm kur ai ishte prapa grilave. Në gjykimin e tretë, së bashku me Demaçin, në vitin 1975, u përfshinë edhe këta veprimtarë: Skënder Kastrati, Hasan Dërmaku, Rexhep Mala, Hetem Bajrami, Osman Dumoshi, Isa Kastrati, Sami Dërmaku, Selatin Novosella, Xhavit Dërmaku, Ilaz Pireva, Fatmir Salihu, Sherif Masurica, Zijadin Spahiu, Ahmet Hoti, Nijazi Korça, Irfan Shaqiri, Ilii Ramadan dhe Nazim Shurdhani.

127. Ismail Syla, shkrimtar: Adem Demaçi komunikoi me lexuesin në frymën e dialektikës. Në shkrimet, deklaratat dhe intervistat e tij Adem Demaçi, ndonjëherë, i korrigjon deklaratat e mëparshme, pa lënë aspak përshypjen e lëvizjes joparimore. Në përshatjen me frymën dialektike të ecurisë së dukurive dhe personave, Demaçi e përshtat edhe mendimin pa rënë në kundërtënie.

128. Ismet Hajrullahu, profesor në Kolegjin "Iliria" në Prishtinë: Adem Demaçi, në vitet e '90-ta propozoi krijimin e Këshillit Kombëtar Adem Demaçi, me kohë, e dha sinjalin e alarmit për rezikun që i kanosej çështjes kombëtare nga konfuzioni i programeve të partive politike në Kosovë gjatë viteve të '90-ta të shekullit që lamë pas. Për këtë qëllim Demaçi propozoi shkriren e tyre dhe krijimin e një Këshilli Kombëtar, me një program të vetëm për zgjidhjen e çështjes së Kosovës.

129. Ismet Hamiti, drejtor i Postë - Telekomit të Kosovës: Sakrifika e Adem Demaçit frymëzoi dhe bashkoi popullin. Sakrifika e Adem Demaçit frymëzoi dhe bashkoi tërë popullin tonë rreth një qëllimi të madh që ishte çlirimi nga robëria jugosllave. Demaçi dhe Mendela, këto dy personalitete të rralla, sakrificuan për një ideal të madh. Por, realizimin e idealeve të mëdha e bëjnë

shoqëritë e jo individët.

130. Ismet Rashiti, veprimtar i daluar i çështjes kombëtare: Adem Demaçi, personaliteti i madh i popullit shqiptar. Në Gjenevë, më 20 gusht 1983, është organizuar një Orë letrare kushtuar Adem Demaçit, në të cilën, përveç tjerash, është theksuar se kjo Orë letrare i kushtohet personalitetit të madh shqiptar, shkrimtarit dhe patriotit të shquar, Adem Demaçit, i cili dekada më radhë po dergjet në burgjet jugosllave për të drejtat dhe liri kombëtare të popullit shqiptar në Jugosllavi.

131. Ismet Salihu, profesor i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina": Adem Demaçi, vigan i popullit shqiptar.

Vigani, i cili, në tunelin e gjatë dhe të errët të robërisë shekullore të shqiptarëve të Kosovës, që reflekton të lirinë është Adem Demaçi.

132. Ismet Sylejmani, veprimtar i çështjes kombëtare: Adem Demaçi u frymëzua nga qëndrimi burror i Ramiz Cërnica.

Kush e ka frymëzuar Adem Demaçin për ta themeluar organizatën "Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve" më shumë se sa qëndrimi burror i tribunit të kombit, Ramiz Cërnica: Me Serbinë - JO! Me Shqipërinë - PO!

133. Isuf Sherifi, veprimtar i çështjes kombëtare: Është e drejtë që Mendela të quhet Demaçi i Afrikës së Jugut. Nëse vlerësojmë angazhimet politike, nuk ka se përse të thuhet që Demaçi na qenka Mendela i Kosovës, kur e njëjta mund të vlejë edhe për Mendelën, pra, Mendela, njëkohësisht, mund të ketë qenë Demaçi i Afrikës së Jugut.

134. Izber Hoti, punëtor Shkencor i Institutit të Historisë së Kosovës "Ali Hadri":

Biografia e Adem Demaçit ndër më të veçantat. Biografia e Adem Demaçit nuk mund të kompletohet pa shkrimet e t'ia letrare dhe publicistike, ndërsa këto nuk mund të trajtohen, shqyrtohen e kapërcehen pa marrë në shënjestër edhe rrafshin historik.

135. Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës: Adem Demaçi çdo gjë e bënte për popullin dhe Atdheun. Çdo shqiptar i cili mendon, flet e punon shqip, duhet ta dijë se Adem Demaçi, si dje, ashtu edhe sot, çdo gjë e ka bërë dhe e bënë, për popullin dhe Atdheun.

136. James Pettifer, historian: Adem Demaçi i shpalli luftë të hapur Jugosllavisë në vitin 1964. Organizata e Adem Demaçit quhej "Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve" dhe organizonte veprimtarinë klandestine për lirinë e Kosovës. Në prill të vitit 1964 nisi lufta e hapur kundër Jugosllavisë, kur flamuri shqiptar kuq e zi ilegal u shpallori në mbarë Kosovën.

(Vijon)

Më 22 shkurt promovohet monografia "Paraqitja dhe zhvillimi i ekstremizmit islamist në Kosovë dhe vendet e rajonit"


Promovohet monografia e Kolë Krasniqit

Më 22 shkurt, në orën 11.00, në sallën "Konstandin Shpataraku" në Muzeun Historik Kombëtar në Tiranë, bëhet promovimi i monografisë "Paraqitja dhe zhvillimi i ekstremizmit islamist në Kosovë dhe vendet e rajonit" të autorit dr. Kolë Krasniqit, me parathënie nga prof. dr. Pajtim Ribaj dhe prof. James Albrecht, USA

Një pjesë hyrëse nga libri:

Kosova dhe përgjithësisht rajoni i Ballkanit gjithmonë ka qenë territor ku janë takuar dhe janë ndarë civilizimet dhe ndikimet e Fuqive të Mëdha. Këtu është takuar dhe është ndarë ndikimi i kishës katolike romake nga ajo ortodokse bizantine, ndikimi i fesë islame nga krishterimi, ndikimi i interesave gjeostrategjike të botës lindore nga ato të botës perëndimore etj. Këto kryqëzime kulturore dhe fetare si dhe ndikime të interesave të ndryshme gjeostrategjike kanë ndikuar që në Kosovë, gjatë shekujve të kaluar të zhvillohen kultura të ndryshme rivale, kisha rivale dhe besime të ndryshme fetare, të cilat nganjëherë kanë qenë edhe kundërshtarë të njëra-tjetrës. Pavarësisht nga diversiteti fetar dhe kulturor, populli i Kosovës, asnjëherë deri me tani nuk i ka trajtuar këto ndarje ideologjike si kufi të ndarjes së vetë kombëtare në baza fetare, por gjithmonë ka kultivuar ndjenjat e harmonisë, tolerancës dhe të mirëkuptimit ndaj pjesëtarëve të komuniteteve të tjera fetare. Mirëpo, fatkeqësisht, kohët e

fundit ka filluar të sulmohet modeli tradicional i harmonisë dhe tolerancës fetare që është kultivuar me shekuj në Kosovë. Zanafilla e këtyre sulmeve shtrihet që në fillim të vitit 1992, kur në Bosnjë filloi lufta qytetare dhe Shqipëria u anëtarësua në Organizatën e Konferencës Islamike. Gjatë këtij viti filloi ardhja e pakontrolluar e disa organizatave "humanitare" në rajon dhe shkuarja e dhjetëra të rinjve kosovarë për arsimim fetar në disa qendra islamike të Lindjes së Afërt. Kështu disa individë dhe grupe të personave që erdhën si "misionarë" nga Lindja e Afërt, filluan veprimtarinë e tyre subversive në drejtim të nxitjes së ekstremizmit islamist dhe përhapjes së një ideologjie radikale në të gjitha territoret e banuara me popullsi myslimane në Ballkan. Gjatë kësaj kohe ishte suspenduar autonomia politike në Kosovë dhe regjimi i instaluar diktatorial serb ushtronte forma të ndryshme të diskriminimit etnik ndaj popullsisë shqiptare. Ky pozicion kolektiv i shqiptarëve përballesh rrezikut të përbashkët nga regjimi serb, ka ndikuar në fuqizimin e ndjenjave të unitetit dhe të harmonisë kombëtare dhe



të "nacionalizmit shqiptar" në përgjithësi. Me qëllim të luftimit të "ideologjisë ekspansioniste kombëtare shqiptare", që paraqiste rrezikun serioz për stabilitetin politik të regjimit diktatorial serb në Kosovë, ishte stimuluar përhapja e ideologjisë radikale islamiste, si një ideologji konsumuese, komprometuese dhe aleate për luftimin e nacionalizmit shqiptar. Në këto rrethana, të karakterizuara edhe me shkatërrimin e sistemit të arsimit dhe me kriza të thella sociale, ekonomike dhe politike, u paraqit radikalizmi islamist në Kosovë, i cili u zhvillua në mënyrë të shpejtë dhe të papenguar si një proces tejet dinamik duke u manifestuar viteve të fundit edhe në formën e qartë të veprimtarisë ekstremiste dhe në disa raste edhe terroriste.

Në realitet, rrethanat e paraqitjes dhe zhvillimit të ekstremizmit islamik në Kosovë janë unikate edhe nga fakti se shumica absolute e popullit shqiptar shprehin publikisht respektin ndaj të kaluarës së tyre të krishterë dhe falënderimin ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian për ndihmat e ofruara gjatë luftës për çlirimin e vendit dhe për përkrahjen e gjithanshme për krijimin e shtetit të Kosovës dhe njohjen ndërkombëtare të tij. Me qëllim të ruajtjes së vlerave demokratike, Policia e Kosovës në bashkëpunim me strukturat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, kanë ndërmarrë një varg masash operative me qëllim të luftimit të veprimtarisë ekstremiste dhe terroriste në Kosovë. Kështu, vetëm gjatë dy viteve të fundit, Policia e Kosovës ka iden-

tifikuar 316 kosovarë, në mesin e tyre edhe dy atentatorë vetëvrasës, 44 gra dhe 29 fëmijë, që u janë bashkuar formacioneve të ISIS-it në Siri dhe në Irak. Sipas këtyre të dhënave zyrtare, Kosova në raport me numrin e saj të popullsisë, qëndron në vendin e parë në Evropë për nga numri i luftëtarëve të huaj që veprojnë në Siri dhe në Irak. Ndërkaq, gjykatat kosovare, deri më tani kanë dënuar 57 persona dhe kanë akuzuar 93 të tjerë për kryerjen e veprave të ndryshme terroriste. Ndaj 134 personave të tjerë janë duke u zhvilluar hetimet. Këto të dhëna zyrtare dëshmojnë se ekstremizmi islamist në Kosovë, në të gjitha format e manifestimit të vet, paraqet një kërcënim serioz për sigurinë kombëtare. Shkalla e rrezikut nga ekstremizmi islamist rritet edhe nga bashkëpunimi gjithnjë e më i dukshëm në mes grupeve të ndryshme radikale dhe atyre ekstremiste islamike në rajon, që mundësohet nga motivi, ideologjia e njëjtë fetare dhe e kaluara e përbashkët "xhihadiste". Ky rrezik është konkretizuar edhe me kthimin e rreth 120 personave nga zonat e luftës në Siri dhe Irak dhe nga veprimi operativ i disa shërbimeve të huaja inteligjente në Kosovë. Nga kjo arsye, qeveria e Kosovës së bashku me institucionet ndërkombëtare në Kosovë, në interes të mbrojtjes së rendit demokratik dhe të drejtave të njeriut, duhet ta konsiderojnë luftën kundër ekstremizmit islamist si njërën nga detyrat e veta parësore.

Marrëveshje mes MKRS-së e DokuFest-it për Evropën Kreative

PRISHTINË, 14 SHKURT (ER) - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me "DokuFest"-in, i cili ka për synim krijimin e rrjetit evropian dhe regional të partneritetit kulturor dhe kreativ në Kosovë. Memorandumi i nënshkruar të mërkurën nga ministri Kujtim Gashi dhe Eroll Bilibani, drejtor ekzekutiv i "DokuFest"-it, përkrahur edhe nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), ka për qëllim mbështetjen dhe fuqizimin e sektorit kulturor dhe kreativ në Kosovë përmes projektit "Kosova Kreative". Projekti në fjalë do të ndihmojë në përgatitjen e pranimit të aplikacioneve në programin kornizë të Komisionit Evropian për mbështetje të sektorit kulturor dhe audiovizual "Evropa Kreative" duke hartuar një doracak të praktikave dhe mësimëve më të mira nga organizatat që kanë përvojë për zbatimin e programit në fjalë dhe krijimin e një databaze

ndërsektoriale kulturore dhe audiovizuale të organizatave kulturore, artistëve individualë, industrisë së filmit, e të tjerë nga Evropa, që janë të interesuar në bashkëpunim me organizatat simotra në Kosovë; dhe organizatave kulturore, artistëve individualë, industrisë së filmit e të tjerë nga Kosova. Gjithashtu, memorandumit parasheh adresimin e prioritetëve dhe aktivitetëve që derivojnë nga programi "Evropa Kreative". Aktivitetet e parapara në bazë të memorandumit do të realizohen dhe implementohen nga "DokuFest"-i. "Dokumenti që kemi nënshkruar sot, dhe për rrjedhojë doracak dhe databaza që do të dizajnohen, do ta mundësojnë krijimin e partneriteteve të reja mes sektorit kulturor nga Kosova dhe Evropa. Përmes kësaj nisme do të nxitin politika e ide të reja kulturore dhe do të rritet kreativiteti dhe do të ketë interesim më të madh të audiencës", ka thënë ministri Gashi.





FORÇA JONË

* * * Viti VII • Nr. 65 • 14 Shkurt 2018 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës të Kosovës * * *

FSK-ja dhe KFOR-i përruruan urën e restauruar mbi lumin Sitnica në Mitrovicë

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, zotëri Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, komandanti i KFOR-it, gjeneral major Salvatore Cuoci si dhe udhëheqës lokalë dhe qytetarë të tjerë morën pjesë në ceremoninë e rihapjes së urës mbi lumin Sitnica në Mitrovicë, (30.01.2018) pas kryerjes së punimeve për riparimin dhe rindërtimin nga Batalioni i Xhenios së FSK-së në bashkëpunim me KFOR-in.

Me këtë rast, ministri Rrustem Berisha tha se Forca e Sigurisë së Kosovës po dëshmon çdo ditë e më shumë se me kapacitetet në kuadër të misionit të saj është e gatshme dhe e aftë të planifikojë dhe realizojë në tërësi projekte të infrastrukturës të cilat e lehtësojnë jetën e qytetarëve si dhe mundësojnë qarkullimin e lirë të njerëzve, automjeteve dhe mallrave në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Duke përcjellur përgëzimet e Qeverisë, ministri Berisha tha se tani me përfundimin me sukses të riparimit në urën mbi lumin Sitnica, xhenierët e FSK-së treguan profesionalizëm dhe përkushtim të lartë si dhe dëshmuar një gatishmëri për ndërveprim me trupat e KFOR-it gjatë kryerjes së punimeve.



Nga ana e tij, ministri Berisha deklaroi se ndjehet krenar për punën profesionale dhe vetëmohuese të pjesëtarëve të FSK-së, gjithashtu edhe për disiplinën dhe angazhimin ekipor të tërë ekipeve që punuan edhe gjatë ditëve të vikendit, vetëm e vetëm që kjo vepër të jetë sa më parë në shërbim të qytetarëve të Mitrovicës dhe lokaliteteve përreth.

Komandanti i KFOR-it, gjeneral major Salvatore Couci tha se FSK-ja është Forcë

e të gjithë qytetarëve të Kosovës, dhe se ne jemi krenar me punën e tyre dhe profesionalizmin e treguar. Ndër tjera ai tha: „Sikurse në këtë operacion të përbashkët, KFOR-i do të vazhdojë të mbështesë FSK-në në zhvillimin e kapaciteteve të saj në kuadër të misionit që ka aktualisht. FSK-ja ka demonstruar profesionalizëm të lartë në operacione të tilla si ky”, duke përfunduar se. Në urën mbi lumin Sitnica në Mitrovicë, punuan gjithsej 15 pjesëtarë të FSK-së me

pajisje xheniere dhe 9 automjete, nga data 24 janar deri më datë 29 janar. Angazhimi kryesor ishte vendosja e dyshemesë së urës, me gjatësi 45,72 metra, gjerësi 4.20 metra, si dhe kryen inspektimin teknik të urës për çdo element metalik të vendosur aty, në mënyrë që ura e riparuar t'i përmbahet standardit në përballimin e peshës prej 50 tonelatave.

FSK-ja ka lehtësuar jetën e qytetarëve dhe ka mundësuar lëvizjen e lirë të udhëtarëve dhe automjeteve me ndërtim urash dhe projekte tjera humanitare edhe në Kramovik, Deçan, Krushevë e Vogël të Klinës, mbi lumin Drini i Bardhë, Mitrovicë dhe në lokalitete tjera të Kosovës, dhe me këtë ka dëshmuar profesionalizëm, gatishmëri si dhe përkushtim për të provuar në veper investimin që populli i Kosovës po e bën për institucionet dhe se ato ua kthejnë përmes sigurisë dhe investimit në punë.

Vlen të theksohet se xhenierët e FSK-së kanë qenë të përfshirë edhe në operacionin humanitar pas vërshimeve në Republikën e Shqipërisë ku kanë punuar dhe asistuar në ndërtimin dhe montimin e urave si dhe pritjet që të dislokohen përsëri për të vazhduar me operacione në Shqipëri, po për këtë qëllim, pra ndërtimin dhe montimin e urave të tipit modern Mabey Johnson.

Komandanti i FSK-së morri pjesë në Forumin Ndërkombëtar në Komandën e Forcave Ajrore të NATO-s në Gjermani



Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, me ftesë të Komandantit të Ushtrisë Amerikane për Evropë, gjeneral major Timothy Mc Guire, mori pjesë në Forumin Ndërkombëtar të Zjarrit Luftarak në Komandën e Forcave Ajrore të NATO-s në Gjermani.

Në Forumin Ndërkombëtar morën pjesë përfaqësues ushtarakë të më se njëzet vendeve anëtare të NATO-s, ku u diskutua lidhur me trendët e reja në teknologjinë e zjarrit luftarak, ndërveprueshmërinë e zjarrit indirekt në fushat luftarake, si dhe për mësimet e mësuara nga operacionet e tanishme.

Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama ka falënderuar përfaqësuesit e Ushtrisë Amerikane për përkrahjen dhe mbështetjen e vazhdueshme, si dhe për mundësitë e gjithanshme që po merr nga partnerët strategjikë në të mirë të avancimit dhe zhvillimit profesional të FSK-së.

Oficerë të FSK-së trajnohen në Mbretërinë e Bashkuar

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe këshilltari i tij ushtarak nga Mbretëria e Bashkuar, nënkoloneli Gregor Lindsay, (10.01.2018) përcollën tre oficerët e rinj të FSK-së, nëntogerët Besfort Kurteshi dhe Eugen Thaçi dhe togerin Ismail Hoxha, për një trajnim profesional në akademitë më prestigjioze të Mbretërisë së Bashkuar.

Dërgimi i oficerëve të FSK-së, për trajnim profesional në Mbretërinë e Bashkuar shënon fillimin e një viti të suksesshëm të marrëdhënieve shumë të mira mes ushtrisë së Mbretërisë së Bashkuar dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK).

Këta pjesëtarë të FSK-së, paraqesin shembullin e rritjes së FSK-ja duke dëshmuar se udhëheqësit e saj të rinj janë oficerë profesionistë të gatshëm për sfidat që e presin në të ardhmen.

Nëntogeri Besfort Kurteshi do të jetë pjesë e Akademisë Ushtarake Mbretërore Sandhurst. Ky është kandidati i 18-të i FSK-së që shkollohet në këtë akademi ushtarake. Në Sandhurst, Kurteshi do të shërbejë së bashku me mbi 100 liderë të ardhshëm, pjesëtarë nga ushtria e Mbretërisë së Bashkuar dhe ushtritë e shteteve tjera.

Ndërsa, nëntogeri Eugen Thaçi do të qëndrojë në Edinburg të Skocisë, për një para-trajnim që drejtohet nga Shkolla e Trajnimit të Këmbëorisë. Nëntogeri Thaçi do të studiojë taktikat e Ushtrisë Britanike dhe do të mësojë të përdorë pajisjet britanike në kushtet e dimrit scocez. Pas këtij trajnimit sfidues, Thaçi do të shkojë edhe në Uells, ku do të jetë oficeri i dytë i FSK-së, për të kryer Kursin Luftarak për komandant të togës. Nëntogeri Thaçi si udhëheqës i ekipit në Ushtrimin „Shqiponja Patrolluese 2017”, ka treguar aftësitë për komandimin e këmbëorisë. Megjithatë ai do të sfidohet ende nga trajnimi intensiv dhe kushtet e vështira që mund të gjenden në Uells.


Kurse togeri Ismail Hoxha, pas sukseseve në Ak-



ademinë Ushtarake Sandhurst, ku fitoi „Shpatën” si studenti më i mirë ndërkombëtar, dëshmoi aftësi profesionale edhe në garën me prestigjioze „Cambrian Patrol” ku zuri vendin e parë me njësitin e tij.

Të gjitha këto njohuri profesionale të fituara në Mbretërinë e Bashkuar ai, i zbatoi me sukses në praktikë në Batalionin e Parë të Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH) ku vepron. Togerin Ismail Hoxha kësaj radhe do të jetë në cilësinë e instruktorit të FSK-së, në Britani të Madhe. Togerin Hoxha, në Mbretërinë e Bashkuar, gjegjësisht në Skoci, do të kryejë detyrën e instruktorit për t'i mësuar kadetët britanikë. Ai gjithashtu do të qëndrojë edhe në Uells, në cilësinë e instruktorit në Kursin Luftarak për Komandant të Togut. Shumë rrallë ndodhë të zgjedhën si instruktor nga personeli ndërkombëtar për të udhëzuar dhe trajnuar oficerët britanikë. Kjo është një kredi e madhe për togerin Ismail Hoxha dhe FSK-në.

Ministri Rrustem Berisha priti ambasadorin Qemal Minxhozi dhe atasheun ushtarak kolonel Ahmet Leka



Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, z. Rrustem Berisha, priti sot (12.01.2018) në takim zyrtar ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Prishtinë, z. Qemal Minxhozi dhe atasheun ushtarak të Republikës së Shqipërisë, kolonelin Ahmet Leka i akredituar atashe rezident në Republikën e Kosovës. Ministri Berisha, me këtë rast, e njoftoi ambasadorin Minxhozi, me të arriturat e përgjithshme të MFSK-së dhe FSK-së, si dhe e falënderoi për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm në mes Ministrisë së Forcës së Sigurisë të Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu ministri Berisha foli edhe për procesin e transformimit të FSK-së në Forcat e Armatosura të Kosovës.

Ministri Berisha me ambasadorin Minxhozi bisedoi edhe për bashkëpunimin e ndërsjellë në fushën e shkollimit dhe të trajnimeve për pjesëtarët e FSK-së në Re-

publikën e Shqipërisë dhe pjesëtarëve të Forcave të Armatosura të Shqipërisë në Kosovë, duke u ndërlidhur me Qendrën e trajnimit të Kërkim-Shpëtimit në Pomezotin dhe Qendrën Universitare të FSK-së, ku studiojnë edhe kadetë nga Republika e Shqipërisë, si dhe biseduan edhe për zgjerimin e bashkëpunimit në të gjitha fushat me interes të përbashkët.

Ndërsa atasheut ushtarak, koloneli Ahmet Leka i uroi detyrën e re duke i afruar bashkëpunim nga ana e tij dhe MFSK-së. Ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Kosovë, z. Minxhozi, me këtë rast falënderoi ministrin Berisha, komandantin e FSK-së dhe FSK-në, për intervenimin e shpejtë në Republikën e Shqipërisë, pas vërshimeve duke iu dalë në ndihmë qytetarëve të Shqipërisë. Ai theksoi se ky bashkëpunim është në interes jo vetëm të dyja shteteve, por edhe në interes të paqes dhe sigurisë në rajon dhe më gjerë.

Komandanti i FSK-së në ceremoninë e ndërrimit të Komandës së Ushtrisë Amerikane për Evropë



Rahman Rama, me këtë rast takoi komandantin e SHBA-ve për Evropë, gjeneralin Curtis Scaparrotti. Gjeneral Rama gjatë takimit e njoftoi gjeneralin Scaparrotti me zhvillimet e fundit në Kosovë, si dhe me progresin e përgjithshëm të FSK-së duke u ndalur me theks të veçantë në integrimin e pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë në FSK. Komandanti i FSK-së, gjeneralletënant Rahman Rama, me këtë rast, e siguroi gjeneralin Scaparrotti dhe partnerët tanë strategjikë se „FSK-ja do të vazhdojë të jetë e të gjithë qytetarëve të Kosovës, pa dallime etnike dhe e përkushtuar për vazhdimin e bashkëpunimit të mirë me KFOR-in dhe të gjitha institucionet tjera të sigurisë”.

Në këtë ceremoni, komandantit i FSK-së shoqërohej nga atasheu amerikan në Kosovë, koloneli Jeffrey Fischer.

Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), gjeneralletënant Rahman Rama, më 18.01.2018, mori pjesë në ceremoninë e ndërrimit të komandantit të Komandës së Ushtrisë Amerikane për Evropë, që u mbajt në

Wisbaden të Gjermanisë, me ç'rast detyrën e komandantit e mori gjeneralletënant Christofer G. Cavoli. Gjeneralletënant

FSK-ja pjesë e seminarit “Vlerësimi i pozitave të ndjeshme nga rreziku i dukurive korruptive”



Në kuadër të procesit të zbatimit të projektit “Ndërtimi i Integritetit të MFSK-së dhe FSK-së”, në Vjenë më 12.01.2018, u mbajt takimi me temën “Vlerësimi i pozitave të ndjeshme nga rreziku i dukurive korruptive”, organizuar nga Qendra për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes (Centre for Integrity in the Defence Sector- CIDS) e Ministrisë së Mbrojtjes të Mbretërisë së Norvegjisë.

Në këtë takim morën pjesë: Ministria për FSK-në, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Shkëlzen Sylaj dhe komandanti i FSK-së gjeneralletënant Rahman Rama; përfaqësues nga Ministria e Mbrojtjes së Bosnjës dhe Hercegovinës.

Gjithashtu, në këtë takim ishin të pranishëm edhe përfaqësuesi nga CIDS z. Sven Eriksen, eksperti i fushës përkatëse nga Kosova, z. Florian Qehaja si dhe ekspertët rajonalë.

Nga ana e tij, zyrtari i lartë nga Ministria e Mbrojtjes së Bosnjës dhe Hercegovinës, prezantoi politikën përkatëse që zhvillohet

në Ministrinë e tyre respektivisht “Rregulloren për vlerësimin e pozitave të ndjeshme nga rreziku i dukurive korruptive”.

Përveç diskutimeve rreth rregullores në përgjithësi dhe metodologjisë së vlerësimit në veçanti, debati u zhvillua edhe në funksion të hartimit të politikave, procedurave të duhura dhe akteve normative të nevojshme për ngritjen e integritetit në institucionet tona të nivel të ministrive dhe forcave. Pastaj u diskutua edhe për implementimin e planeve të integritetit me masat dhe veprimet konkrete në funksion të parandalimit, eliminimit dhe reduktimit të dukurive korruptive dhe në përgjithësi atyre negative të cilat cenojnë funksionalitetin e ministrive dhe operacionalitetin e forcave tona.

Në përmblyllje të takimit me përfaqësues nga Bosnja e Hercegovina u diskutua për hapat e ardhshëm në zgjerimin e bashkëpunimit ndërmjësor dhe shkëmbimit të përvojave në fusha respektive në mes të MFSK-së /FSK-së dhe MM të BeH.

Obelisk për ushtarët e NATO-s të rënë në Kosovë

Sot (26.01.2018) në ambientet e Komunës së Prishtinës, ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, z. Rrustem Berisha u prit në një takim pune nga kryetari i Komunës së Prishtinës, z. Shpend Ahmeti. Në këtë takim ministri Berisha e ka uruar kryetarin Ahmeti, për rizgjedhjen në krye të Komunës së Prishtinës. Nga ana e tij, kryetari i Komunës së Prishtinës z. Ahmeti, shprehu kënaqësinë për vizitën e ministrit Berisha dhe vlerësoi pozitivisht bashkëpunimin në mes MFSK-së, përkatësisht FSK-së, me Komunën e Prishtinës. Qëllimi i këtij takimi ishte koordinimi i punëve

lidhur me iniciativën e ministrit Rrustem Berisha për ndërtimin e Obeliskut (Përmendores), për ushtarët e NATO-s të rënë në Kosovë në vitin 1999. Kjo iniciativë i është paraqitur Qeverisë së Kosovës nga ministri FSK-së, z. Berisha, e cila e ka nxjerrë vendimin për ndërtimin e Obeliskut më 27.12.2017. Në takim, ministri i FSK-së, z. Berisha dhe kryetari i komunës, z. Ahmeti kanë biseduar për procedimin për gjetjen e lokacionit të përshtatshëm duke pasur në konsideratë rëndësinë e obeliskut, si dhe kriteret urbanistike të qytetit të Prishtinës.

Ministri dhe komandanti i FSK-së dekoruan oficeren e Gardës Kombëtare të Ajovës



Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK) Rrustem Berisha dhe komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) gjeneraljtënant Rrahman Rama, më 24.01.2018, nderuan me mirënjohje dhe dekoruan me medalje major Jodi Marti, Oficer për Marrëdhënie Bilaterale pranë zyrës së ODC-s, pas përfundimit të suksesshëm të detyrës së saj në MFSK. Ministri Berisha e falënderoi major Marti për punën dhe angazhimin e saj dyvjeçarë në Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe çmoi përkul

shtimin e saj në ngritjen e profesionalizmit të pjesëtarëve të FSK-së, ndikimin e saj në donacionet që i janë dhënë FSK-së, si dhe në avancimin e bashkëpunimit me Ajovën. "Takohemi sot në shenjë respekti të major Martit, për kontributin dhe mbështetjen e saj për FSK-në në të gjitha fushat si dhe në thellimin e bashkëpunimit të FSK-së me SHBA-të dhe konkretisht me Gardën Kombëtare të Ajovës. Faleminderit major Jodi Marti për këtë bashkëpunim dhe për mbështetjen tuaj, kurse pasardhësit tuaj i uroj

mirëseardhje dhe vazhdim të bashkëpunimit dhe sigurisht avancimin e tij", -u shpreh ministri Berisha.

Gjeneral Rama në fjalën e tij tha se qëllimi i këtij koktej ka qenë falënderimi ynë për punën dhe kontributin e major Jodi Martit për Kosovën dhe veçanërisht për FSK-në. Edhe motoja "All of Kosova all of Ajova" (e tëra e Kosovës e tëra e Ajovës) nënkupton që gjithçka që ka të bëjë me Kosovën ka të bëjë edhe me Ajovën. "Bashkëpunimi dypalësh më i mirë që kemi është ai me Ajovën, falë punës së palodhshme të oficerëve amerikanë ku pjesë e tyre pa dyshim është edhe major Jodi. Faleminderit Jodi. Suksese në të ardhmen. Ju jeni pjesë e historisë sonë", -u shpreh gjeneral Rama, duke përmendur po ashtu edhe bashkëpunimin jo vetëm në fushën e sigurisë por edhe në fusha të tjera. Gjeneral Rama i ndau major Jodi Martit "medaljen për shërbim vetëmohues".

Major Jodi Marti u shpreh mjaft e kënaqur për gjithë organizimin që ministri dhe komandanti kishin përgatitur për të. Ajo nënvizoi se çelësi i këtij bashkëpunimi të mirë është interesimi i vazhdueshëm për të punuar së bashku. Major Marti theksoi se nga të gjitha bashkëpunimet tjera të SHBA-së me vendet tjera, bashkëpunimi mes Ajovës dhe FSK-së është shembulli më i mirë. "Ju falënderoj të gjithëve për këtë organizim. Dy vjet shkuan shpejt, por kemi arritur shumëçka brenda kësaj kohe. Jam pjesë e historisë suaj dhe shpresoj gjatë kësaj kohe sa kam shërbyer këtu njerëzit të thonë që gjërat në FSK janë më mirë se vitet e kaluara", - përfundoi Jodi.

Ministri Berisha priti ekspertin nga Ministria e Mbrojtjes së Norvegjisë, z Eriksen



e Mbrojtjes së Mbretërisë së Norvegjisë. Në takim u bisedua për bashkëpunimin ndërmjet dy ministrive, që ka filluar prej vitit 2012 si dhe për rezultatet e këtij bashkëpunimi, sidomos në hartimin e Planit të Integritetit për Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Ministri Berisha dhe eksperti norvegjez z.Eriksen gjithashtu shprehen gatishmëri që bashkëpunimi të vazhdojë në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes duke identifikuar me kujdes fushat që Ministria e FSK-së dhe FSK-ja do t'i konsideronin me prioritet, në të cilat do të fokusohet mbështetja nga Norvegjia.

Në takim morën pjesë edhe shefi i kabinetit të ministrit, zotëri Jashar Ramadani si dhe drejtori i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë, zotëri Florian Qehaja.

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, zotëri Rrustem Berisha priti sot (31.01.2018) në takim, zotëri Svein Eriksen nga Ministria

MFSK-ja dhe KHAIA-ja nënshkruajnë Memorandum bashkëpunimi



Një delegacion i Komandës së SHBA-ve vizitoi Qendrën Koordinuese për Deminim të FSK-së



Një delegacion nga Komanda e SHBA-ve për Evropë, udhëhequr nga koloneli Chuck Crosby dhe kapiteni Mark Hall, më 22.01.2018, qëndroi për vizitë në Qendrën Koordinuese për Deminim në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Delegacioni u prit nga drejtori i kësaj qendre z. Ahmet Sallova dhe zyrtari i lartë Agron Haziri. Me këtë rast, drejtori Sallova i njoftoi mysafirët për

progresin e arritur në pastrimin e zonave të prekura nga minat dhe mjetet e tjera të pashpërthyer në Republikën e Kosovës, me resurset e tanishme në dispozicion për pastrim, si dhe me planet për pastrimin e zonave të mbetura në të ardhmen.

Në takim gjithashtu u diskutua edhe për sfidat dhe për mundësitë e zhvillimit të mëtejshëm të operacioneve të deminimit.

Në Zyrën e Kryeministrit, të premtën (26.01.2018), është nënshkruar Memorandumi i bashkëpunimit në mes Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës (MFSK) dhe Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA). Memorandumi është nënshkruar nga sekretari i përgjithshëm i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Dr. Shkelzen Sylaj dhe kryesuesi i KHAIA-së, z. Mirsim Beqiri. Ky memorandum bashkëpunimi rregullon mënyrën e afrimit të mbështetjes së Forcës së Sigurisë së Kosovës për KHAIA-

në, në rast të ndonjë aksidenti ajror ose hekurudhor në Republikën e Kosovës.

Mbështetja do të ofrohet nga njësitë e kërkim-shpëtim të FSK-së, me qëllim të gjetjes së personave të zhdukur, kutive të zeza si dhe materialeve të tjera, objekt i hetimeve dhe kërkimeve të KHAIA-së. Gjithashtu FSK-ja do të mbështesë KHAIA-në në transportin e mbetjeve në rast të një aksidenti të fluturakeve dhe trenave nga vendi i transportit deri në lokacionin e caktuar nga Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike.

Kadetët e FSK-së realizojnë tra



Kadetët e Qendrës për Studime Universitare kanë mbajtur trajnimin semestral për vitin 2018. Sipas planifikimit paraprak kadetët e QSU-së kanë qenë të ndarë në dy grupe:

Grupi i parë: Kadetët e vitit të katërt-generata 2018, kanë zhvilluar vizita nëpër njësitet e FSK-së për t'u njohuar më për së afërmi me misionin, strukturën, detyrat, trajnimet, organizimin dhe funksionimin e këtyre njësjive. Kjo vizitë nëpër njësitet e FSK-së ishte shumë e mirëpritur dhe frytdhënëse për kadetët të cilën janë në prag të diplomimit dhe gradimit si oficerë të

Forcës. Grupi i dytë: Kanë qenë të përfshirë kadetët e tri gjeneratave tjera, të cilët kanë zbatuar në praktikë ato njohuri që i kanë mësuar gjatë semestrit të kaluar të vitit akademik 2016/2017 në QSU. Bazuar në plan-programin e QSU-së, kadetët janë trajnuar dhe vlerësuar sipas nivelit të tyre; kadetët e vitit të parë janë trajnuar dhe testuar kryesisht në lëvizjet taktike dhe operacionet në nivel ekipi; ata të vitit të dytë janë avancuar deri në nivel skuadre; ndërsa, kadetët e vitit të tretë janë trajnuar dhe vlerësuar kryesisht në punimin e Urdhrave Operacionalë përmes zbatimit të Procedurës së Udhëheqjes

Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes zhvillohen kurse profesionale



Sot (16.01.2018) në kazermën "Skënderbeu" të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), të FSK-së në Ferizaj, u mbajt ceremonia e fillimit të mbajtjes së kurseve për pjesëtarët e FSK-së, për vitin shkollor 2018.

Në këtë ceremoni ishin të pranishëm: zëvendësministri Burim Ramadani, ko-

mandanti i FSK-së, gjeneralletjënant Rrahman Rama, komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, zëvendëskomandanti i KFT-së, gjeneral brigade Gezim Hazrolli, zëvendëskomandanti i KFOR-it, gjeneral brigade Janos Csombok, atashëu ushtarak i SHBA-ve kolonel Jeffrey Fischer dhe oficerë të lartë dhe pjesëtarë të FSK-së.

Në emër të ministrit Rrustem Berisha, ceremoninë e përshëndeti zëvendësministri Burim Ramadani i cili përgëzoi FSK-në, për të arriturat e përgjithshme gjatë vitit 2017, duke shprehur përkushtimin për avancimin, ngritjen, trajnimin dhe profesionalizimin e institucioneve të sigurisë për të gjithë qytetarët e Kosovës. „Ngjarja e sotme është një hap i madh për dëshminë e suksesit të FSK-së. Ministria jonë është në mbështetje të plotë të secilës fushë, duke përfshirë mbështetjen për Komandën e Trajnimeve dhe Doktrinës në avancimin e punës së saj profesionale, programit të trajnimeve dhe ngritjes së kapaciteteve“, shtoi zëvendësministri Ramadani. Ai në vazhdim të fjalës së tij tha se „Qeveria e Kosovës dhe MFSK-ja po punojnë me përkushtim në përmblylljen e suksesshme të procesit të transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës, duke ofruar kështu një mundësi me vlerë të veçantë për sigurinë rajonale dhe më gjerë.

Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjeneralletjënant Rrahman Rama theksoi se kjo ceremoni shënon fillimin e trajnimeve për vitin 2018. Mund t'ju them, tha ai, se si komandant i FSK-së jam i kënaqur me planifikimet që janë bërë. Gjeneral Rama duke iu drejtuar pjesëtarëve të FSK-së, shtoi se: "motivimi, gatishmëria dhe disiplina për

të marrë njohuri të reja duhet të jetë motivi shtesë për arritje të reja individuale".

Komandanti i FSK-së, duke folur për detyrat dhe sidat tha se "zhvillimi i FSK-së është në një fazë thelbësore për ardhmen e Republikës së Kosovës. Ju e dini që ky vit është përcaktues për ndryshimet e shumë pritura për transformimin e saj në Forca të Armatosura".

Ndërsa komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), gjeneral brigade Enver Cikaqi, gjatë fjalës së tij, tha: "Për të realizuar misionin tonë, ne zhvillojmë kurse të ndryshme profesionale me anë të të cilave synojmë aftësimin e pjesëtarëve tanë, duke ndikuar në ngritjen e një force profesionale, të gatshme të përballlet me sfidat e kohës".

Ai njoftoi se gjatë vitit 2018, në KDS, do të realizohen 35 kurse me gjithsej 74 gjenerata të kursantëve pjesëmarrës nga të gjitha njësitë e FSK-së, të cilat do të zhvillohen në: Qendrën për Zhvillim Profesional të Udhëheqësve, Qendrën e Stërvitjes Specialistike, Qendrën e Stërvitjes Kolektive, Qendrën e Stërvitjes Bazike dhe në Qendrën për Studime Universitare".

Në fund gjeneral Cikaqi foli edhe për bashkëpunimin intensiv dhe profesional që ka KDS-ja me partnerët ndërkombëtarë.



Trupave të Forcave të Sigurisë së Kosovës gjatë trajnimit semestral për vitin 2018

së Trupave (PUT), në nivel togu. Ky trajnim është realizuar në poligonet trajnuese të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj, në kushte të rënduara atmosferike dhe temperatura të ulëta, me qëllim të përgatitjes sa më të mirë fizike, mentale dhe profesionale të Trupës së Kadetëve të QSU-së. Ata u sfiduan në zhvillimin e operacioneve të ndryshme ofensive, defensive, operacione të mbështetjes së paqes duke u testuar në aftësitë e tyre të marrjes së vendimeve të drejta dhe të shpejta në ambiente stresuese dhe nën presion të kohës.

Bashkëpunimi me partnerët tanë nga GLSH-L, Bondsteel edhe këtë herë ishte i shkëlqyer. Ata ofruan bashkëpunim në planifikimin dhe realizimin praktik të evakuimit mjekësor (MEDEVAC) me helikopter. Kjo ishte një përvojë e re dhe shumë e mirëpritur për shumicën e kadetëve të QSU-së. Për t'u njoftuar më për së afërmi me realizimin e aktiviteteve gjatë trajnimit semestral kadetët janë vizituar nga ZVKOMKDS kolonel Irfete SPAHIU e cila u nda e kënaqur me punën, aktivitetin dhe motivimin e tyre dhe stafin e QSU-së.?



Ministri dhe komandanti bëjnë homazhe në nderim të martirëve dhe dëshmorëve në Reçak

Ministri Rrustem Berisha dhe komandanti i FSK-së, gjeneralletjënant Rrahman Rama së bashku me stafin e lartë të MFSK/FSK-së, sot morën pjesë në shënimin e 19-të vjetorit të masakrës së Reçakut. Në Kompleksin Përkujtimor (15.01.2018) ata vendosën lule dhe bënë homazhe te varrezat duke nderuar të gjithë martirët dhe të rënë të Lirë. Ministri Berisha dhe komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, gjatë vizitës në Kompleksin Përkujtimor takuan qytetarët e pranishëm të Reçakut, të cilëve ju shprehën ngushëllimet dhe njëkohësisht edhe krenarinë për familjarët e tyre, duke çmuar lartë sakrificën e të rënëve të Reçakut.

Ministri Berisha ndër të tjera tha se „Liria që ne po e gëzojmë sot dhe Pavarësia e Kosovës i kanë rrënjët në gjakun e dëshmorëve, martirëve dhe të gjithë të rënëve për shtetin e pavarur të Kosovës”.



Ministri dhe komandanti i FSK-së bëjnë homazhe te shtatorja e Zahir Pajazitit

Ministri Rrustem Berisha dhe komandanti i FSK-së, gjeneralletjënant Rrahman Rama së bashku me një delegacion të MFSK/FSK-së, sot (31.01.2018) në përvjetorin e 21-të të rënies së heronjve të kombit Zahir Pajaziti, Edmond Hoxha dhe Hakif Zejnullahu, vendosën lule dhe bënë homazhe te shtatorja e Zahir Pajazitit, në sheshin që e mban emrin e tij, në qendër të Prishtinës.

Ministri dhe komandanti i FSK-së, me këtë rast, nderuan veprën e heronjve të kombit, të cilët 21 vite më parë ranë në krye të detyrës ndaj Atdheut në fshatin Pestovë.



Ministri i FSK-së Rrustem Berisha priti një delegacion të deputetëve nga radhët e komuniteteve

Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), ministri Rrustem Berisha priti sot në vizitë një delegacion nga radhët e komuniteteve, të prirë nga Veton Berisha, deputet i Kuvendit të Kosovës, Bashkim Krasniqi zëvendësministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Isa Osmani këshilltar i Kryeministrit dhe Arlind Zogaj pjesëtar i FSK-së.

Ministri Berisha ka falënderuar delegacionin për vizitën e parë të realizuar në Ministrinë e FSK-së dhe njëherësh i njoftoi ata për të arriturat e përgjithshme të FSK-së, aktivitetet e tanishme si dhe planet për zhvillimin e FSK-së dhe transformimin e saj në Forca të Armatosura të Kosovës.

Ministri Berisha, mysafirët i njoftoi edhe për misionin duke u shprehur se FSK-ja është një forcë profesionale dhe shumetnike që i përket gjithë popullit të Kosovës dhe është

në shërbim të gjithë qytetarëve pa dallime etnie. Ai i njoftoi edhe me përfaqësimin e FSK-së, duke vënë theksin te pjesëtarët e komuniteteve egjiptian dhe ashkalinj, të cilët me përgjegjësi të madhe i kryejnë detyrat e përgjithshme dhe janë shembull i bashkëpunimit dhe mirësjelljes në radhët e FSK-së.

Deputeti i Kuvendit të Kosovës, z. Veton Berisha, në emër të delegacionit që përfaqësonte e ka falënderuar ministrin Berisha për pritjen si dhe e ka përgëzuar për punën dhe të arriturat e përgjithshme, duke u shprehur se është pro formimit të Forcave të Armatosura të Kosovës.

Gjatë takimit u bisedua edhe për mundësinë e përfshirjes së pjesëtarëve të komunitetit egjiptian dhe atij ashkali në radhët e FSK-së.



Shefi i Shtabit të KFOR-it vizitoi Qendrën Koordinuese për Deminim në MFSK



Sot (11.01.2018) në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) qëndroi për një vizitë zyrtare shefi i Shtabit të KFOR-it, gjeneral brigade Randy Powell, me bashkëpunëtorë. Ai u prit nga drejtori i Qendrës Koordinuese për Deminim, z. Ahmet Sallova dhe zyrtari i lartë Agron Haziri.

Me këtë rast, drejtori Sallova e falënderoi gjeneralin Powell për vizitën dhe përmes një prezantimi të shkurtër e njoftoi me progresin e arritur deri me tani në pastrimin e zonave të afektuara nga minat dhe mjetet tjera të pashpërthyer në Republikën e Kosovës, me resurset e tanishme për pastrim, si dhe planet për pastrimin e zonave të mbetura në të ardhmen.

Gjatë takimit të dyja palët vlerësuan lart

bashkëpunimin e deritashëm në mes të njësiteve të EOD-s të FSK-së dhe të njësiteve të EOD-s të KFOR-it, duke e konsideruar këtë bashkëpunim si mjaft të dobishëm sidomos gjatë ekzekutimeve të detyrave të EOD-së. Po ashtu është diskutuar mundësia e organizimit të një ushtrimi të përbashkët për evakuim mjekësor gjatë operacioneve të deminimit.

Nga ana e tij, shefi i Shtabit të KFOR-it, gjenerali Randy Powell u nda i kënaqur me progresin e arritur deri me tani në operacionet e deminimit, dhe njëherësh premtoi që KFOR-i do të vazhdojë me përkrahjen e nevojshme për mbështetjen e njësiteve të FSK-së dhe organizatave tjera të përfshira në pastrimin e zonave të minuara.

Interesim i madh për dhurim të gjakut në FSK

Bazuar në planin e veprimit për vitin 2018 të Drejtorisë për Politika dhe Plane, përkatësisht Departamentit për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak dhe Departamentit të Mjekësisë në MFSK, në koordinim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut të Kosovës (QKT-GJK), sot në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës filloi aksioni humanitar për dhurimin e gjakut. Këtij aksioni iu përgjigjen një numër i madh i pjesëtarëve të FSK-së dhe stafit civil të Ministrisë për FSK-në.

FSK-ja tashmë ka një traditë të organizimit të aksioneve humanitare për dhurimin vullnetar të gjakut, me moton „një pikë gjak për shpëtimin e një jete”.

Ndër të parët që iu përgjigjen këtij aksioni humanitar ishte zëvendësministri i MFSK-së, z. Burim Ramadani dhe shumë oficerë të lartë dhe stafit civil të Ministrisë. Zëvendësministri Ramadani me këtë rast tha: „FSK-ja gjithmonë i përg-

jigjet jo vetëm aksioneve të organizuara për dhurimin e gjakut, por edhe sa herë paraqitet nevoja dhe bëhen thirrje individuale për ndihmë përfshirë edhe dhurimin e gjakut”.

Ndërsa, dr. Bukurije Zhupi nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut të Kosovës, tha: „Pjesëtarët e FSK-së janë bërë një shembull i mirë për të ndihmuar qytetarët e Kosovës dhe për ngritjen e vetëdijes te qytetarët që t’i përgjigjen aksionit humanitar për dhurimin e gjakut dhe aksioneve të ngjashme humanitare”. Aksioni humanitar për dhurimin e gjakut në kuadër të FSK-së realizohet në dy faza brenda vitit.

Vlen të theksohet se që në ditën e parë, këtij aksioni i janë përgjigjur 50 pjesëtarë të MFSK-së. Aksioni do të vazhdojë nesër në kazermën „Adem Jashari” të Komandës së Forcave Tokësore dhe do të zgjasë deri më 22 shkurt 2018, në të gjitha njësitet dhe kazermat e FSK-së.



Gjeneral brigade Kirk Van Pelt nga Garda Kombëtare e Arkansasit viziton KDS-në

Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneral brigade Enver Cikaqi në ambientet e Kazermës „Skënderbeu” në Ferizaj, më 30 janar 2018, priti në një takim miqësor ndihmës asistentin e gjeneralit të Gardës Kombëtare të Arkansasit, gjeneral brigade Kirk Van Pelt të shoqëruar nga komandanti i kampit ushtarak amerikan „Bondstill”, kolonel Michael Spraggins.

Me këtë rast, gjeneral Cikaqi e njoftoi delegacionin amerikan me misionin, detyrat dhe të arriturat e KDS-së, si dhe bashkëpunimin e deritashëm me ushtrinë amerikane me theks të veçantë me ushtarët amerikanë në Bondstill.

Gjeneral Cikaqi vlerësoi lart përkushtimin dhe ndihmën e SHBA-së në ngritjen e kapaciteteve të FSK-së, ndihmën që i kanë dhënë KDS-së në përgatitjen dhe realizimin e stërvitjeve dhe certifikimin e instruktorëve, adaptimit të programeve për kurset që realizohen në KDS prej vitit 2009 e deri më sot, si dhe shprehu besimin dhe gatishmërinë e tij që ky bashkëpunim



të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Ndërsa, gjenerali Pelt, pasi u njoh nga afër me KDS-në, punën, angazhimin dhe të arriturat e pjesëtarëve të FSK-së tha: „Ndjehem i lumtur kur shoh se ju keni arritur një standard të lartë të përmbushjes së misionit, dhe më vjen mirë kur dëgjoj se ushtarakët tanë kanë kontribuar për të ndërtuar një institucion të përgatitur siç është Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes, me standarde dhe kapacitete të larta”.

Në fund gjeneralët Cikaqi dhe Pelt u shprehën se bashkëpunimi do të vazhdojë edhe në të ardhmen në mes FSK-së dhe ushtrisë amerikane me qëllim të ngritjes së aftësive dhe profesionalizmit të pjesëtarëve të FSK-së.

Oficeri i lartë amerikan, gjeneral brigade Kirk E. Van Pelt ka vizituar Bondstillin si dhe ka shprehur interesimin për të vizituar KDS-në.

Vizita është realizuar në kuadër të bashkëpunimit në mes të KDS-së/FSK-së me Grupin Shumëkombësh Luftarak Lindje (Bondstill).

FSK-ja evakuon nxënës nga Prevala



Njësisia Ndërlidhëse për Reagim në Kriza e FSK-së, pas vlerësimit dhe rishikimit të zonës në Brezovicë për të verifikuar se mos ka të izoluar nga bllokimi i rrugës nga dëborat, ka marrë një informacion plotësues se një grup i nxënësve kanë udhëtuar këmbë në drejtim të Prevallës.

Rreth orës 22:00 janë evidentuar 19 nxënës nga Gjakova. Këta nxënës të ngelur në

rrugë dhe dëborë, janë ndihmuar nga njësisia e FSK-së e cila ka bërë transportimin e tyre nga Prevala në Gjakovë.

Grupi i nxënësve janë ribashkuar me familjet e tyre në Gjakovë rreth orës 03:00 të mëngjesit.

Në këtë operacion kanë qenë të angazhuar pjesëtarët e Njësisë Ndërlidhëse për Reagim në Kriza dhe të Brigadës për Mbështetje Operacionale të FSK-së.

Policia e FSK-së realizon trajnim në Bondsteel



Në kuadër të bashkëpunimit mes FSK-së dhe KFOR-it, për dy javë, në kampin Bondsteel, Policia e Forcës së Sigurisë së Kosovës (PFK) ka realizuar trajnimin „Zbatimi i Ligjit në Policinë Ushtarake”. Ky trajnim është realizuar nga instruktorë të Policisë Ushtarake Amerikane. Trajnimi ka filluar më 15 janar dhe ka përfunduar dje më 30. 01.2018. Trajnimi është fokusuar në temat: Reagimi në aksident të trafikut dhe hetimi i aksidentit; Ndalesat në trafik; Ndalesat në trafik me rrezikshmëri të lartë etj. Ky trajnim si dhe

trajnimet tjera që janë realizuar nga instruktorët e Ushtrisë Amerikane janë rezultat i bashkëpunimit në mes dy vendeve.

Në fund të trajnimit, (31.01.2018) instruktorët amerikanë u pritën nga zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, i cili i falënderoi për ndihmën e dhënë në ngritjen profesionale për pjesëtarët e FSK-së. Me këtë rast gjenerali Gëzim Hazrolli ndau mirënjohje për instruktorët e angazhuar në këtë trajnim.

FSK-ja përfundoi operacionin e kërkim-shpëtimit në lumin Erenik

Sot, (06.01.2018) rreth orës 11.30, Njësi-ti i specializuar i Kërkim-Shpëtimit në Ujëra i FSK-së, arriti ta gjejë trupin e pajetë të 82 vjeçarit, Mustafë Haxhisë, i cili kishte rënë në lumin Erenik të Gjakovës.

Ekipe të Kërkim-Shpëtimit të FSK-së, pas marrjes së informacionit se një person ishte zhdukur në ujërat e lumit Erenik të Gjakovës, u angazhuan në kërkimin e trupit të tij dhe pas një kërkimi përgjatë rrjedhës së

lumit në gjatësi prej 9 km, arritën ta gjejnë trupin e pajetë të të ndjerit, në kilometrin e gjashtë të rrjedhës së Lumit Erenik. Trupi i pajetë iu dorëzua Policisë së Kosovës.

Në këtë operacion ishin të angazhuar edhe Drejtoria për Emergjencat e Kuvendit Komunal të Gjakovës, Policia e Kosovës, një ekip mjekësor i emergjencës së spitalit të Gjakovës dhe zjarrfikësit e Gjakovës.



Xhenierët e FSK-së, gjatë këtij muaji, ngritën dy ura metalike-mobile; mbi lumen Sitnicë në Mitrovicë, dhe në fshatin Zëmbllak të prefekturës së Korçës-Shqipëri.



Mattisi nuk ka njohuri për vrasjen e mercenarëve rusë nga amerikanët

Pentagoni tha se nga sulmet në Deir al-Zor të Sirisë, javën e kaluar, janë sulmuar trupat qeveritare të Sirisë, që e kishin sulmuar një bazë të forcave amerikane dhe atyre opozitare siriane, duke i vrarë rreth 100 sulmues, por sekretari amerikan i Mbrojtjes, Jim Mattis, thotë se nuk ka njohuri se nga sulmet ajrore të ShBA-së janë vrarë dhjetëra ushtarë mercenarë rusë në Siri



WASHINGTON, 14 SHKURT - Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Jim Mattis, thotë se nuk ka njohuri se nga sulmet ajrore të Shteteve të Bashkuara janë vrarë dhjetëra ushtarë mercenarë rusë në Siri, megjithëqë ai ka parë raporte në media për vrasjet e këtu.

Pentagoni tha se nga sulmet në Deir al-Zor të Sirisë, javën e kaluar, janë sulmuar trupat qeveritare të Sirisë, që e kishin sulmuar një bazë të forcave amerikane dhe atyre opozitare siriane, duke i vrarë afro 100 sulmues. "Kjo tash po raportohet në shtyp", tha Mattis dhe ka shtuar se "nuk kam asnjë raport se disa rusë, që nuk janë ushtarë të Federatës Ruse, por kontraktorë rusë, ishin në mesin e viktimave". "Ne nuk e kemi marrë këtë njoftim në Komandën Qendrore ose në Pentagon", tha Mattis.

Një zëdhënës i presidentit të Rusisë, Vladimir Putin, po ashtu ka thënë se nuk ka njohuri për ndonjë vrasje të rusëve në sulmin më 7 shkurt. Por, mediet kanë raportuar se fafesi dhe kolegët e ushtarëve mercenarë rusë kanë thënë se dhjetëra rusë mund të jenë vrarë nga sulmet.

Departamenti i Mbrojtjes i ShBA-së ka njoftuar se i kishte lansuar sulmet ajrore, pasi më se 500 sulmues e kishin filluar atë që duket se ishte sulm i koordinuar, kundër një baze të forcave opozitare siriane, të shoqëruara nga këshilltarët amerikanë në Deir al-Zor.

I pyetur gjatë një dëgjimi në Komitetin e Inteligjencës të Senatit të Shteteve të Bashkuara, nëse ka

ndodhur ndonjë vrasje e mercenarëve rusë, drejtori i agjencisë CIA, Mike Pompeo, tha pa elaboruar se "nga perspektiva e inteligjencës, ne kemi parë në shumë raste forcat e jashtme duke i përdorur mercenarët në betejë, që do të fillojnë t'u qasen ShBA-së".

Më herët, Pentagoni ka refuzuar t'i identifikojë 100 ushtarët, për të cilët tha se ishin vrarë nga sulmet ajrore amerikane. "Nuk do të spekuloj për kompozicionin e kësaj force ose nën kontrollin e kujt ishte ajo", tha gjenerali Jeffrey Harrigian, zëdhënës i Komandës Qendrore të ShBA-së, dhe ka shtuar se "ne jemi të fokusuar në armikun e vetëm - IS-in".

Ai theksoi se "Ushtria amerikane nuk synon luftë me dikë tjetër por, siç ka thënë sekretari Mattis, javën e kaluar - nëse ju na kërcënoni, do të jetë dita juaj më e gjatë dhe më e vështirë".

Gjatë fundjavës janë paraqitur raporte në blogjet ruse dhe tjetër kund, se një numër i panjohur i ushtarëve rusë me kontratë janë vrarë. Ministria e Mbrojtjes e Rusisë ka thënë se asnjëri prej ushtarëve të vet nuk ishte në atë territor dhe ka sugjeruar se luftëtarët e Qeverisë së Sirisë ndoshta kanë dështuar t'i koordinojnë aksionet e tyre me Ushtrinë ruse.

Zyrtarët amerikanë thanë, po ashtu, se gjatë sulmit të tyre ata ishin në kontakt me Ushtrinë ruse, nëpërmjet linjës speciale "të nxehtë" të krijuar nga të dyja palët për evitimin e incidenteve armiqësore ndërmjet dy armatave.

Conflict Intelligence Team me seli në Moskë, që e monitoron përfshirjen ruse në konfliktet në Siri dhe Ukrainë, i ka identifikuar tre rusë, për të cilët tha se ishin në mesin e atyre që janë vrarë.

Organizata Cossack në Kaliningrad të Rusisë nëpërmjet postimit në mediet sociale, tha se një pjesëtar i vet është vrarë.

Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, ka thënë se intervenimi i Rusisë në Siri, që ka filluar në fund të vitit 2015, është në rënje e sipër dhe në dhjetor të vitit të kaluar ka urdhëruar që të tërhiqen ushtarët e uniformuar rusë.

Njëherësh, një numër i panjohur i rusëve, që punojnë për kompanitë private ushtarake, kanë shërbyer së bashku me trupat e rregullta ruse. Kompania PWC Vagner, në Shën Petersburg, ishte një nga më të njohurat.

E përditshmja ruse "Novaya Gazeta", tha se 13 rusë ishin vrarë në sulm, ndërsa 15 të tjerë janë plagosur. Agjencia "Bloomberg", duke i cituar dy rusë të paemëruar, ka raportuar se më tepër se 200 ushtarë me kontratë janë vrarë në sulm.

E përditshmja "New York Times", e ka cituar një oficer ushtarak sirian, që ka thënë se afro 100 ushtarë rusë janë vrarë.

I pyetur për këto raporte, Dmitry Peskov, zëdhënës i presidentit të Rusisë, Vladimir Putin, u tha dje gazetarëve në Moskë, se Qeveria ka njohuri vetëm për aksionet e ushtrisë së Rusisë në Siri. "Ne nuk kemi informacion për rusët e tjerë, që mund të jenë në Siri", tha Peskov.

LAJME SHKURT



Fqinjët e Afganistanit premtajnë bashkëpunim për siguri

KABUL, 14 SHKURT - Misioni i NATO-s në Afganistan ka thënë se shefat e ushtrisë regionale kanë premtuar bashkëpunim në luftimin e terrorizmit dhe drogës gjatë konferencës dyditore të mbajtur në Kabul.

Zëdhënësi i misionit, kapiteni Tom Gresback, ka thënë se zyrtarët e mbrojtjes nga 12 shtete kanë "ritheksuar përkushtimin e tyre për luftimin e terrorizmit në rajon dhe kanë diskutuar mënyra për të punuar së bashku lidhur me çështjet e narkotikëve dhe shqetësime të tjera".

Disa nga vendet pjesëmarrëse kanë qenë Afganistani, Kazakistani, Kirgizia, Pakistani, Tashikistani, Turkmenistani, Uzbekistani dhe Shtetet e Bashkuara. "Ne kemi interes të përbashkët që Afganistani të mos jetë më kurrë strehë e sigurt për terrorizmin", ka thënë komandanti i forcave amerikane në Afganistan, gjenerali, John Nicholson. "Ne do të vazhdojmë t'i sulmojmë kudo që i gjejmë. Do ta vazhdojmë kërkimin brenda këtij shteti", ka deklaruar Nicholsoni. Në mesin e pjesëmarrësve kanë qenë edhe shefi i Komandës Qendrore Amerikane, (CENTCOM), gjenerali Joseph Votel, komandanti i forcave amerikane në Afganistan, gjenerali John Nicholson dhe shefi i stafit të Ushtrisë së Pakistanit, gjenerali Qamar Javed Bajwa.

Pakistani është duke u përballur me presion në rritje nga zyrtarët afganë dhe ata amerikanë për të marrë hapa kundër militantëve që veprojnë në këtë shtet.



Kryeministri holandez shpëtoi në votëbesim në parlament

HAGË, 14 SHKURT - Kryeministri i Holandës, Mark Rutte, me shumicë votash në parlament, i shpëtoi shkarkimit, disa orë pasi ministri i tij i Jashtëm dha dorëheqje, pasi pranoi se ka gënjyer se ka marrë pjesë në një takim me presidentin e Rusisë, Vladimir Putin.

Ministri i Jashtëm, Halbe Zijlstra, të martën paraqiti dorëheqje pasi pranoi në parlament se ka gënjyer se personalisht e ka dëgjuar Putinin duke folur në vitin 2016, për planet për krijimin e "Rusisë së madhe" në Evropë.

Ligjvënësit opozitarë ishin të tmerruar me këtë mashtrim të ministrit Zijlstra dhe kanë kërkuar votim të mosbesimit për kryeministrin në Dhomën e Ulët të Parlamentit të Holandës. Por, votimi ishte në favor të kryeministrit Rutte me 101 vota për dhe 43 kundër. Rutte më parë e ka mbrojtur ministrin Zijlstra, duke thënë se vërejtjet e tij për ekspansionizmin rus tingëllojnë si të vërteta.

Rikthehet modeluesja 62-vjeçare



Ajo ka bërë një kthim gradual në skenë, pasi ka qëndruar jashtë saj, që pas vdekjes së bashkëshortit David Bowie, në janar të 2016-s. Bëhet fjalë për modeluesen Imani, e cila ka treguar këtë javë aftësitë e saj prej


supermodele, kur mori pjesë në një shfaqje të veçantë të Black Panther. 62-vjeçarja dukej e mahnitshme kur mbërriti në Muzeun e Artit Modern me një fustan të argjendtë, të cilin e kishte kombinuar me një shall të vendosur bukur në kokë.

Angelina, e tëra në të zezë



Angelina Jolie kishte nisur procedurat për divorc nga Brad Pitti 17 muaj më parë, megjithatë divorci ende nuk është finalizuar. Negociatat për paratë dhe kujdestarinë e fëmijëve duken të jenë rraskapitëse për fituesen e çmimit Oskar, veçanërisht tani që të dy kanë

kërkuar për zgjatje të procesit. Këto zhvillime si duket e kanë munduar aktoren pasi që në paraqitjen e saj të fundit, ajo nuk dukej në elementin e saj më të mirë. Madje ajo ishte veshur e tëra në ngjyrë të zezë, teksa po zbriste shkallët e një ndërtese në Los Angeles.



Dua Lipa, këngëtarja më e pëlqyer

Vazhdon të ngjitet me shpejtësi në shkallët e karrierës këngëtarja shqiptare. Bëhet fjalë për Dua Lipën e cila me këngën "New Rules" ka arritur një miliard klikime. Ka qene vetë Dua e cila e ka bërë me dije këtë fakt në rrjetin social "Instagram", me ç'rast ka publikuar një fotografi të saj kur ka qenë e vogël. Krah fotos këngëtarja shqiptare shkruan: "Kapa telefonin dhe zbulova se jam artistja më e re femër që merr 1 miliard klikime në një video muzikore".



Gigi Hadid kritikohet për rënie nga pesha

Adhuruesit e kanë kritikuar supermodeluesen Gigi Hadid për rënie në peshë. Bukuroshja ka reaguar në rrjetin social në "Twitter", me ç'rast ka treguar se rënie në peshë e ka nga sëmundja e Hashimoto, prej së cilës ka vuajtur në moshën 17-vjeçare. Hashimoto është një sëmundje që prek gjëndrat e tiroideve.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

NAPOLI - RB LEIPZIG

GG3+

OSTERSUNDS - ARSENAL

2

LYON - VILLARREAL

GG3+

Llapi dëshmon forcën, kualifikohet në çerekfinale



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 14 SHKURT - Në edicionin e kaluar stadiumi "Riza Lushta" në Mitrovicë ishte i pafat për skuadrën e Llapit, pasi në finale të Kupës ishte mposhtur nga Besa e Pejës, por të mërkurën gjërat ndryshuan dhe Llapi e mposhti Trepçën '89 dhe u kualifikua në çerekfinale të Kupës. Në kuadër të këtij rrethi fitoren më të thellë e siguroi Drenica ndaj Arbërisë me rezultat 7-1. Kualifikimin e siguruan edhe Drita, Prishtina, Vëllaznimi, Gjilani dhe Vushtrria. Shorti për rrethin e katërt do të hidhet të premten në selinë e Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK).

Trepça '89 - Llapi 0-2

Kampioni i vjeshtës, Llapi, është treguar të mërkurën skuadër më e fortë se kampionia aktuale, Trepça '89, pasi ka shënuar fitore 0-2 dhe në këtë mënyrë e ka siguruar kualifikimin në çerekfinale. Përcaktuesi i kësaj ndeshje është vendosur në dhjetë minutat e fundit, kur golat i shënuan Mirlind Daku nga penalltia dhe më pas shënoi edhe Ilir Blakqori. Trajneri nga Shqipëria, Gugash Magani, në këtë mënyrë ka debutuar me humbje në krye të shtabit teknik në skuadrën e 89-shit.

Ballkani - Gjilani 0-1

Ndeshje shumë interesante ishte ajo në mes të skuadrës nga Liga e Parë, Ballkanit dhe skuadrës nga Vala Superliga, Gjilani. Ishte skuadra gjilanase ajo që në fund iu gëzua fitores dhe kualifikimit në raundin tjetër. Pjesa e parë dhe e dyta u mbyllën me rezultat 0-0, kurse fituesi u përcaktua në minutën e fundit të vazhdimit, kur Pleurat Hajdini shënoi golin e fitores për skuadrën e Arbnor Morinës. Tash skuadrës nga Theranda i mbetet të luftojë që të inkuadrohet në elitë, kurse Gjilani do ta vazhdojë garën edhe në Kupë.

Prishtina - Kosova (P) 5-0

Prishtina është treguar superiore në ndeshjen ndaj Kosovës së Prishtinës, duke shënuar fitore me rezultat të thellë 5-0. Golat për skuadrën "bardhekalter" i shënuan Bozhoviç, Januzi, Curri, Mankenda dhe Khalid. Prishtina, krahas garës në Kupë, është një prej favoriteve kryesore për titull të kampiones në Superligë.

Drenica - Arbëria 7-1

Drenica nga Skenderaj ka shkëlqyer ndaj Arbërisë, duke shënuar fitoren më të thellë në kuadër të rrethit të katërt 7-1. Katër gola në këtë ndeshje

i ka shënuar Genc Hamiti, nga një gol e shtuan Taulant Dajaku, Kreshnik Uka dhe një autogol, kurse golin e nderit për skuadrën mysafire e shënoi Urim Statovci.

Kualifikohen Drita, Vushtrria dhe Vëllaznimi

Skuadrës së drejtuar nga Bekim Isufi, Dritës i ka mjaftuar një gol për të arritur në çerekfinale. Skuadra nga Gjilani e mposhti në stadiumin "Demush Mavraj" skuadrën e Istogut me rezultat 0-1, kurse të vetmin gol në këtë ndeshje e ka realizuar Haxhi Neziraj në minutën e 15. Ndërkohë, Vushtrria e ka eliminuar Lirinë, pas ekzekutimit të penalltive 6-5, ngaqë ndeshja në kohën e rregullt dhe pas vazhdimëve përfundoi 1-1. Në çerekfinale është kualifikuar edhe Vëllaznimi, pasi e mposhti 3-1 skuadrën e Rahovecit.

REZULTATET	
Prishtina - Kosova (P)	5-0
Trepça '89 - Llapi	0-2
Drenica - Arbëria	7-1
Istogu - Drita	0-1
Vëllaznimi - Rahoveci	3-1
Ballkani - Gjilani	0-1
Vushtrria - Liria	1-1 (6-5 pas vazhdimëve pas penalltive)

SHKURT

Sot zhvillohen ndeshjet e basketbollit

Ndeshjet e xhiros së XX në IP Superligën e Kosovës në basketboll do të zhvillohen sot (e enjte), ku Trepça është nikoqire e Rahovecit, takim ky që do të luhet në palestrën "Minatori" në Mitrovicë me fillim nga ora 18:00. Ndërsa duke filluar nga ora 19:00, në Therandë, Golden Eagle Ylli e pret Pejën, kurse në të njëjtin orar do të përballen edhe Kerasan Prishtina - Bashkimi, si dhe në orën 19:30 Sigal Prishtina do të ballafaqohet me Borean.

Mavraj: Mungesa e golit? Unë jam mbrojtës

Situata sa vjen e rëndohet për ekipin e Hamburgut, ku bën pjesë lojtari i Kombëtares së Shqipërisë, Mërgim Mavraj. Përveç mbijetesës, në klub po zien çështja e mungesës së golit, ndërsa Mavraj, i pyetur nga një media afër klubit mbi këtë çështje, hoqi përgjegjësinë nga vetja. "Unë jam një mbrojtës dhe nuk ua kam idenë golave, pasi e shoh portën nga larg. Nuk e përjashtoj mundësinë që lojtarët janë të nervozuar dhe kërkojnë të shënojnë me forcë golat", ka thënë Mavraj për "Hamburger Morgenpost".

Panucci mund të largohet nga Shqipëria

E përditshmja e qytetit të Ferrarës, "La Nuova Ferrara", ka publikuar lajmin, ku përmend emrin e trajnerit të Kombëtares shqiptare të futbollit, Christian Panucci, si një mundësi për ta drejtuar stolin e SPAL-it, që është me një këmbë në Serinë B. "Ka dalë në skenë edhe emri i Christian Panucci, ish-mbrojtës i Milanit, Real Madridit, Interit dhe Romës, ish-zëvendës i Capelos te Rusia, trajner i Livornos dhe Ternanës dhe aktualisht trajner i Kombëtares shqiptare, nga e cila mund të shkëputet për ta marrë drejtimin e një bankine në Itali", transmeton GSH shkrimin e "La Nuova Ferrara".

Lojërat Olimpikë Dimërore: Shtyhet gara e skitares shqiptare

Gara e sllallomit për femra në Lojërat Olimpikë Dimërore, ku do të garojë edhe skiatorja shqiptare Suela Mëhilli, u shty për ditën e premte. Gara që ishte parashikuar të zhvillohej këtë të mërkurë do të niste me provat teknike, por erërat e forta bënë që organizatorët, për arsye sigurie për sportistët, ta vendosin shtyrjen e saj me dy ditë. Ndërkaq, nuk ka ndryshim të datës së garës tjetër ku do të garojë Suela Mëhilli, në sllallomin gjigand. Ajo do të zhvillohet në datën e përcaktuar që në fillim, ditën e enjte, më 15 shkurt. Ndërkohë që, më 18 dhe 22 shkurt do të garojë edhe skiatori tjetër Erjon Tola në sllallomin gjigand dhe atë special. Në këto dy disiplina do të garojë për herë të parë dhe skiatori nga Kosova, Albin Tahiri.

Kosova në mars zhvillon dy ndeshje miqësore

PRISHTINË, 14 SHKURT - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll në muajin e ardhshëm do t'i zhvillojë dy ndeshje miqësore. Federata e Futbollit e

Kosovës (FFK) do të organizojë një kamp përgatitor në Paris të Francës prej 20 deri më 27 mars, kurse ka arritur marrëveshje me Federatën e

Futbollit të Madagaskarit dhe të Burkina Fasos që të zhvillojë dy ndeshje miqësore në Paris. Ndeshja kundër Madagaskarit do të zhvillohet më 24 mars,

derisa ndeshja kundër Burkina Fasos do të zhvillohet më 27 mars, kurse këto ndeshje do të zhvillohen në stadiumet prestigjioze të Parisit me rrethinë.



Turneri aprovoi kushtet e ofruara nga FBK-ja për Kampionatin Evropian U-18

PRISHTINË, 14 SHKURT - Më 13 dhe 14 shkurt në Prishtinë ka qëndruar zyrtarja e FIBA-s, Radmila Turner, e cila e mban pozitën e Udhëheqëses së Federatave Nationale dhe Udhëheqëses për Sport, Rini e Antidoping në FIBA Evropë.

Qëllimi i vizitës së saj ka qenë fillimi i përgatitjeve për Kampionatin Evropian U-18, Divizioni C që do të mbahet në Prishtinë prej 22 deri më 29 korrik 2018. Turneri me këtë rast ka zhvilluar takime pune me udhëheqësen e Komitetit Lokal Organizativ të Kampionatit, sekretaren e përgjithshme të FBK-së, Elvira Dushkun, dhe me anëtarë të stafit të këtij komiteti, si dhe më pas e ka bërë inspektimin e palestrave sportive në Prishtinë ("I Tetori" dhe Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë), hoteleve, ku pritet të akomodohen zyrtarët e FIBA-s, si dhe konviktin ku pritet të akomodohen ekipet pjesëmarrëse të këtij kampionati. "Pas dy ditë pune intensive, Turneri e ka dhënë pëlqimin që kampionati mund të organizohet në kushtet e ofruara nga FBK-




ja, me përjashtim të palestrës 'I Tetori' ku ajo ka kërkuar të bëhen disa ndërhyrje urgjente në mënyrë që ekipet të zhvillojnë në kushte sa më të mira stërvitjet", thuhet në njoftimin e FBK-së. Pas kthimit në Munchen, Turner do të bëjë një raport për vizitën në Prishtinë dhe më pas FBK-ja edhe

zyrtarisht mund të fillojë të punojë për organizimin e Kampionatit Evropian U-18, Divizioni C. Pjesëmarrëse të Kampionatit Evropian U-18, Divizioni C janë: Grupi A: Moldavia, Armenia, Irlanda, Malta, Monako. Grupi B: Qipro, San Marino, Kosova Gjibraltar.

Clevelandi mposhti Oklahomën, fitojnë Houstoni dhe Toronto

OHIO, 14 SHKURT - Clevelandi mposhti 120-112 Oklahomën në ndeshjen e radhës në NBA, një përballje mes dy ekipesh pretendente për titullin kampion në konferencat përkatëse. Një sfidë mjaft e bukur dhe me rivalitet, ku diferencën e bëri LeBron Jamesi, autor i 37 pikëve, lider në fushë për Cavaliersin, ndërkohë që edhe pesë lojtarë të tjerë të skuadrës mike realizuan mbi 10 pikë. Për Oklahomën u dalluan George (25), Anthony (24), Adamsi (22) dhe Westbrook (21), por që nuk mjaftuan për ta evituar humbjen. Fiton edhe ekipi i Houstonit, që triumfoi 126-108 në fushën e Minnesotës, duke "kërcënuar" kampionët e Warriorsit në Perëndim. Townsi realizoi 35 pikë e 12 rebaunde për vendësit,



por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen, ndërsa për Houstonin u dallua Hardeni me 34 pikë e 13 asistime. Skuadra kanadeze e Torontos mundi 115-112 Miamin në një ndeshje me rivalitet dhe emocione deri në fund. Të dyja ekipet e kërkuar fitoren, por minutat e fundit ishin më të mirë për Toronton, ku u dalluan DeRozan me 27 pikë e Lowry me 22. Humbet skuadra e San Antonios, që u mund 117-109 nga Denveri,

në një sfidë ku herë udhëhiqte njëra skuadër e herë tjetra. Jokiçi realizoi 23 pikë, 13 rebaunde e 11 asistime, më i miri në fushë për vendësit, ndërsa për Spursin nuk mjaftuan 26 pikët e Lauvergnës. Skuadra e Milwaukee, falë 21 pikëve të Middletonit, triumfoi 79-92 ndaj Atlantës, ndeshje me rivalitet dhe emocione deri në fund, ndërsa Sacramento mposhti 114-109 ndaj Dallasit, ku u dallua Randolph me 22 pikë.

REZULTATET

Toronto - Miami	115-112
Milwaukee - Atlanta	97-92
Minnesota - Houston	108-126
Oklahoma - Cleveland	112-120
Dallas - Sacramento	109-114
Denver - San Antonio	117-109

SHKURT

Pochettino: E meritum fitoren më shumë sesa barazimin

Trajneri i Tottenham Hotspur, Mauricio Pochettino, ka thënë se "Spurs" e kanë merituar fitoren në ndeshjen ndaj Juventusit (2-2). "Ndeshje fantastike. Ishim të ngathtë dhe pësuam dy gola në nëntë minuta, por karakteri që shfaqëm ishte fantastik. Dua të përgëzoj lojtarët nga 2-0 disavantazh me një kundërshtar të vështurë. E meritum fitoren më shumë sesa barazimin", ka thënë Pochettino, duke shtuar: "Jemi më të pjekur. Ndeshjet e kaluara ekipi u ngrit shumë. Është mirë për kapacitetin që kemi. Ekipi ishte i mrekullueshëm për mënyrën e reagimit. Duhet pak fat në futboll. Ndeshja është e hapur, Juventus është ekip i madh. Shpresojmë të fitojmë në Wembley".

Bayerni, gati 70 milionë për Jamesin

"Sport Bild" ka njoftuar se kampioni i Bundesligës, Bayern Munchen është i gatshëm të paguajë 70 milionë euro për blerjen e James Rodriguezit nga Real Madrid. James iu bashkua Bayernit në formë të huazimit dyvjeçar nga "Los Blancos", por paraqitet e mira kanë ndikuar që drejtuesit e ekipit gjerman të mendojnë seriozisht për blerjen përfundimtare.

Allegri beson se Juve mund ta kualifikohet në çerekfinale

Trajneri italian i Juventusit, Massimiliano Allegri, ka deklaruar se skuadra e tij mund të kualifikohet në raundin tjetër të Ligës së Kampionëve, ani pse ndeshja e parë u mbyll 2-2. "Ishte ndeshje e mirë, Juventus bëri pak gabime dhe këto shkak i presionit. Mëkat që nuk fituam, por ne kemi gjithçka për të kaluar në çerekfinale", ka deklaruar Allegri. Ndeshja e kthimit ndërmjet këtyre dy skuadrave do të zhvillohet më 18 mars në "Wembley" të Londrës.

Italia fiton medaljet e para

Italia fiton medaljet e para në Lojërat Olimpike Dimërore të Pyeongchangut. Në garën e patinazhit të shpejtësisë 500 m për femra, Ariana Fontana i dha medaljen e artë vendit të saj, duke e fituar këtë garë me 42.5 sekonda, për të lënë në vendin e dytë holandezen Van Kerkhof, e cila mori medaljen e argjendtë, ndërsa medalja e bronzit u fitua nga kanadezja Kim Boutin. Medalja tjetër e fituar nga sportistët italianë ishte ajo e argjendtë e marrë nga Federico Pellegrino në garën e Cross Country Sprint për meshkuj. Fitorja e medaljes së artë i takoi norvegjezit Klaebo, ndrsa atë të bronzit e fitoi rusi që garoi nën flamurin olimpik, Aleksander Bolshunov. Ndërsa në Cross Country Sprint për femra, ajo që fitoi ishte suedeza Stina Nilsson, e cila la pas norvegjezen Falla dhe Yulia Belokurova, rusen që garon me flamurin e IOC. Adolehentët amerikanë duket se janë mbretër të snowboard-it. Pas suksesit të Gerrard në Slopestyle, i takoi 17-vjeçares Chloe Kim që të fitojë medaljen e artë në kategorinë e Snowboard Halfpipe me 98.25 pikë të grumbulluara. Në vendin e dytë u rendit kinezja Liu Jiayu me 89.75 pikë, ndërsa medaljen e bronzit e fitoi amerikana Arielle Gold. Në renditjen e përgjithshme të medaljeve kryeson Gjermania me 5 medalje ari, 2 argjendi dhe 2 bronz, e ndjekur në vendin e dytë nga Holanda me 4 medalje të arta, 4 të argjendta dhe 1 të bronzit, ndërsa në vendin e tretë janë SHBA, me 4 medalje ari, 1 argjendi dhe 2 bronz.

Froome: S'kam përdorur doping

Çiklisti britanik Chris Froome ka konfirmuar edhe një herë për mediet se nuk ka përdorur doping, pavarësisht se analizat e dala nga një test antidoping në Vueltnë e Spanjës e kanë nxjerrë atë pozitiv. Froome, që vjet fitoi si Turin e Francës ashtu dhe Vueltnë, deklaroi se gjithçka erdhi si pasojë e përdorimit të një substance prej astmës, ndërkohë që normat e substancës së ndaluar ishin disa herë mbi normën e lejuar. "Nuk kam bërë asgjë të gabuar. Është e vështurë të pranosh këto akuza dhe këtë situatë, por jam përqendruar te gara, tek objektivat e mi. Unë, më shumë se kushdo, dua që ky proces të mbarojë sa më shpejt. Rasti im nuk ka asgjë të ngjashme me atë të Contador, pasi përdori një substancë të ndaluar", deklaroi çiklisti Chris Froome.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Administratës Publike - Ministarstvo Javne Administracije
Ministry of Public Administration

Duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës L. Nr. 03/L - 149 dhe Rregulloren Nr. 02/2011 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Administratës Publike shpall:

KONKURS

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme
Titulli i punës : Arkëtar/c (1 vend pune)
Nr.ref. RN00002767
Kategoria funksionale : Teknik-administrativ
Koeficienti : 6
Lloji i pozitës : JO karrierës
Orët e punës : 40 orë në javë
Kohëzgjatja e emërimit: Nëpunës JO karrierës (me afat të caktuar - zëvendësim) - periudha provuese 3 muaj
Vendi i punës : Ndërtesa "ish Rilindja", Prishtinë
Qëllimi i vendit të punës : Sigurimin e shpenzimeve të parave të gatshme në pajtim me legjislacionin në fuqi
Nëpunësi raporton te : Udhëheqësi i Divizionit për Buxhet dhe Financa

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

1. Menaxhon dhe mirëmban të gjitha transaksionet e parasë së gatshme në institucion;
2. Kujdeset për sigurinë e të gjitha parave të gatshme në institucion;
3. Planifikon dhe kontrollon të gjitha shpenzimet e parasë së gatshme;
4. Mban evidenca për shpenzimet e parasë së gatshme dhe i sistemon në regjistrator përkatës;
5. Rishikon raportet, format, dhe të dhënat për saktësinë, plotësinë, dhe përputhshmërinë e tyre lidhur me shpenzimet e parave të gatshme;
6. Përgatit raportet e parave të imta, dhe përgatit raport lidhur me gjendjen e arkës;
7. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

Shkathësitë e kërkuara:

